



KOMPAKIA RAJONALZ UJESJELLESI S.H.A.
REGIONAL WATER COMPANY J.S.C.
KOMPAKIA REGIONALNI VODOVODI D.O.
MITROVICA
TEL/FAX: 065/623-787, 520-304
Nr. 01-93913

Date: 31.07.25
01/13 2701
31-07-2025
REPUBLICA E KOSOVES / REPUBLIKA KOSOVA
MINISTRIA E EKONOMISE
MINISTARSTVO EKONOMIJE
MINISTRY OF ECONOMY
No. pages: 1
No. of sheets: 1
Org. Unit: 1
Proj. No.: 1
Bil. Proj.: 1
M. Proj.: 1

Plani i Rishikuar i Biznesit 2025-2027

Bordi i Drejtorëve, në mbledhjen e rregullt nr. 06-2025 të mbajtur më datat 29.07.2025 dhe 31.07.2025, pas shqyrtimit të Rishikimit të Planit të Biznesit 2025-2027, miratoi versionin e rishikuar të Planit. Plani i miratuar do t'i dërgohet NJPMNP-së.

	Delegoi	Aprovoi
Emri Mbiemri	Kryeshefi Ekzekutiv: Bashkim Kurti	Kryesuese e BtD-së: Kumrije Kelmendi Aliu
Nënshkrimi		
Data	31.07.25	31/07/2025

KOMPANIA RAJONALE UJËSJELLËSI “MITROVICA” Sh. A.



PLANI I RISHIKUAR I BIZNESIT

Vizioni

Integrimi i teknologjisë së trajtimit të ujit që synon monitorimin në kohë reale duke siguruar standardet më të larta të cilësisë së ujit të pijshëm, por edhe trajtimin proaktiv edhe për ujërat e ndotura për mbrojtje mjedisore, ne synojmë të arrijmë kënaqësi të konsumatorëve duke kontribuar në ngritjen dhe përmirësimin e cilësisë së jetës.

Misioni

Misioni ynë është të ofrojmë vazhdimisht shërbime të nivelit të lartë të ujit si për konsumatorët aktual ashtu edhe për ata të ardhshëm përmes një qasjeje gjithëpërfshirëse në adoptimin e teknologjive të avancuara të filtrimit dhe pastrimit, zbatimin e praktikave të qëndrueshme në menaxhimin e ujit dhe nxitjen e edukimit të komunitetit për ruajtjen e ujit. Angazhimi ynë në mbrojtjen e shëndetit dhe mjedisit do të na mundësojë sigurimin e një ekuilibri ndërmjet përsosmërisë së shërbimeve tona dhe kujdesit ekologjik.

Filozofia

Në qendër të vëmendjes kemi konsumatorin duke synuar të tejkalojmë pritshmëritë e tyre në ofrimin e shërbimeve cilësore përmes praktikave cilësore.

Ne besojmë në fuqizimin e punonjësve tanë përmes zhvillimit të vazhdueshëm profesional, duke u mundësuar atyre të arrijnë potencialin e tyre të plotë. Përkushtimi ynë ndaj përsosmërisë na shtyn të kryejmë çdo detyrë me saktësi dhe kujdes. Duke marrë pjesë aktive në zhvillimin e komunitetit dhe nismat për mbrojtjen e mjedisit, ne përpiqemi të krijojmë një mjedis të qëndrueshëm për të gjithë.

Përmbajtja

1.	HYRJE.....	7
1.1	Përmbledhja Ekzekutive.....	7
1.2	Historiku i Kompanisë	7
1.3	Objektivat Strategjike	11
1.4	Analiza SWOT (Përparësitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Rreziqet).....	11
2.	DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV	14
2.1	Plani i Menaxhimit të personelit.....	14
	Zhvillimi Profesional dhe Trajnimet	15
3.	DEPARTAMENTI FINANCIAR	20
3.1	Analiza e të Ardhurave	21
3.2	Analiza e Shpenzimeve.....	22
3.3	Provizionimi i Llogarive të Arkëtueshme (LL/A)	24
3.4	Menaxhimi i Aseteve	25
4.	DEPARTAMENTI KOMERCIAL.....	26
4.1	Parashikimi i rritjes së numrit të konsumatorëve	27
4.2	Leximi	27
4.3	Faturimi	28
4.4	Arkëtimi/Inkasimi.....	29
4.5	Rishikimi në Departamentin Komercial.....	30
5.	CILËSIA E UJIT	32
5.1	Procesi aktual i monitorimit të ujit të pijshëm.....	33
5.2	Plani për monitorimin e ujit të pijshëm	33
5.3	Investimet e planifikuara për departamentin e cilësisë.....	34
5.4	Trajnimi i stafit të punëtorëve.....	35
5.5	SCADA.....	35
5.6	Analizat fiziko-kimike.....	36
5.7	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik.....	37
5.8	Burimet e ujit	37
6.	DEPARTAMENTI TEKNIK	38
6.1	Hyrje	38
6.2	Humbjet e ujit	40
6.3	Mbulueshmëria me shërbime	41
6.4	Zbulimi i rrjedhjeve	41
6.5	Prodhimi & Operimi në Impiante	42
	SFIDAT.....	47
6.6	PLANI I INVESTIMEVE.....	47
6.7	Draft Lista e Projekteve të KRUM 2025 -2027.....	48
7.	STRATEGJIA E MARKETINGUT & MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN.....	62
7.1	Qëllimi dhe Objektivat Strategjike.....	62
7.2	Komunikimi.....	62
7.3	Marketingu.....	63
8.	SHTOJCAT:.....	64

AKRONIMET

ARRU	Autoriteti Rregullator për Shërbimet e Ujit
ASK	Agjencia Statistikore e Kosovës
BD	Bordi i Drejtorëve
CRM	Customer Relationship Manager (Softueri për Menaxhimin e Marrëdhënieve me Konsumatorin)
EDAMS	Dizajn Inxhinieringu dhe Sisteme të Menaxhimit (Engineering Design and Management Systems).
ITU	Impianti për Trajtimin e Ujit
ITUZ	Impianti për Trajtimin e Ujërave të Ndotura
IKSHP	Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik
KRUM	Kompania Rajonale Ujësjiellësi “Mitrovica”
LUXDEV	Luxemburg Development
MTI	Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
MZHE	Ministria e Zhvillimit Ekonomik
NP	Ndërmarrje Publike
SËOT	Shkathësitë, dobësitë, mundësitë, rreziqet(Stengths Ëeaknesses Oportunities Threats)

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Ndarja e Buxhetit e rishikuar sipas departamenteve për trajnime për vitin 2025	16
Tabela 2. Niveli i edukimit/shkollimit të stafit të kompanisë 2025	18
Tabela 3. Pjesëmarrja gjinore e stafit të kompanisë 2025	19
Tabela 4. Tarifat për vitin 2024 dhe 2025.....	20
Tabela 5. Të hyrat e planifikuara (me veri) të KRUM për vitet 2025– 2027	22
Tabela 6. Shpenzimet e planifikuara të KRUM për vitet 2025 – 2027	23
Tabela 7. Pasqyra e të ardhurave	23
Tabela 8. Numri i planifikuar i konsumatorëve sipas viteve	27
Tabela 9. Rekapitullimi i faturimit në m3 – KRU ‘‘ Mitrovica ‘‘ Sh.A.....	28
Tabela 10. Rekapitullimi – Plani i Faturimit në Euro për 2025 KRU ‘‘ Mitrovica ‘‘ Sh.A. (me Veriun dhe Zveçanin)	29
Tabela 11. Plani i Inkasimit për 2025 – KRU ‘‘Mitrovica’’ Sh.A. pa Komunitet Veriore	30
Tabela 12. Tabela e vlerësimit të konsumatorëve	30
Tabela 13 . Të dhënat mbi konsumatorët shtëpiak dhe jo - shtëpiak	31
Tabela 14. Kapacitetet prodhuese të ITU-ve	42
Tabela 15. Prodhimi real për 6 mujorin e parë të këtij viti sipas raportimeve.	42
Tabela 16. Prodhimi real për njësi Janar- Qershor 2025	43
Tabela 17. Investimet kapitale 2025	47
Tabela 18. Lista e projekteve të rishikuara 2025-2027	50
Tabela 19. Aktivitetet dhe buxheti për Informim Marrëdhënie me Publikun dhe Marketing	63
Tabela 20. Caqet kryesore të performancës të rishikuara	64

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Mbulueshmëria me shërbimet e ujësjellësit.....	10
Figura 2. Mbulueshmëria me shërbimet e kanalizmit	10
Figura 3. Struktura Organizative	17

1. HYRJE

1.1 Përmbledhja Ekzekutive

Plani trevjeçar i biznesit është dokument bazë për menaxhimin e ndërmarrjes përmes planifikimit dhe përcaktimit të objektivave afatgjate i cili paraqet një udhëzues në lidhje me atë se si qëndrojmë, dhe si do t'i arrijmë synimet tona. Plani i Biznesit ofron informatat e nevojshme si për menaxhmentin po ashtu edhe për Bordin e Drejtorëve të Kompanisë Rajonale Ujësjetllësi “Mitrovica” (KRUN) lidhur me afarizmin e ndërmarrjes duke ofruar informatat për vitin aktual – 2024, si dhe planifikimin lidhur me afarizmin e ndërmarrjes për vitin 2025-2027. Në plan shtjellohen dhe përshkruhen veprimet dhe aktivitetet tona bazuar edhe në strategjinë e ndërmarrjes me qëllim të ofrimit të informatave të rëndësishme të cilat janë të domosdoshme për marrjen e vendimeve strategjike të zhvillimit.

Plani i Biznesit 2025 – 2027 është përgatitur në aspektin strategjik dhe operativ të tij nga Menaxhmenti Ekzekutiv i Kompanisë dhe i miratuar nga Bordi i Drejtorëve (BD) të Kompanisë. Duke respektuar Ligjin për Ndërmarrjet Publike në Kosovë, Plani i Biznesi i dërgohet Ministrisë së Ekonomisë (ME) si dokument zyrtar informativ. Plani i Biznesit përshkruan qëllimet, objektivat, strategjitë dhe aktivitetet e propozuara të cilat Kompania synon ti arrijë gjatë periudhës 2025 – 2027 si dhe planet e detajuara të veprimeve/aktiviteteve të cilat do të ndërmerren në mënyrë që të arrihet realizimi i qaveve të parapara në këtë plan.

Menaxhmenti i Kompanisë obligohet për implementimin e këtij plani dhe sipas nevojës edhe rishikimin dhe monitorimin e tij në baza të rregullta të parapara me ligj.

1.2 Historiku i Kompanisë

Ujësjetllësi i Mitrovicës për herë të parë ka filluar punën në vitet e 40-ta të shekullit të kaluar dhe fillimisht kishte obligim furnizimin me ujë të pijes të rreth 20.000 banorëve. Kapaciteti prodhues asokohe ishte rreth 10 l/s, dhe ujin e papërpunuar e siguronte nga lumi Ibër. Trajtimi bëhej në mënyrë natyrale ku si filtra përdorehin shtresat zallore përmes të cilave uji i trajtuar arrinte në pusët e hapura të cilat përdorehin si rezervuarë të ujit të pijshëm.

Në vitin 1983 përfundon ndërtimi i Impiantit për Trajtimin e Ujit (ITU) në Shipol të Mitrovicës i cili fillimisht funksiononte me një kapacitet prodhimi prej 300 l/s.

Me rritjen e popullatës, rritet edhe kërkesa për ujë të pijes, kështu që në vitin 1986 Impianti zgjerohet me ç’ rast rritet kapaciteti i trajtimit të ujit nga 300 l/s në 450 l/s. Që atëherë fillon furnizimi me ujë të pijes për komunat Vushtrri dhe Skenderaj.

Në vitin 2011 për herë të parë lëshohet në funksion Impianti për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (ITUN), ne Laushë të Skenderajt, model ky i pari i këtij lloji në Kosovë me një kapacitet për trajtimin e ujerave të ndotura prej 245 m3/h.

Me rritjen e popullatës dhe zgjerimin e rrjetit të ofrimit të shërbimeve të ujësjellësit, rritet edhe kërkesa për furnizim me ujë të pijes. Kështu lindi nevoja për zgjerimin e kapacitetit prodhues të Impiantit në Shipol. Zgjerimi i Impiantit për Trajtimin e Ujit nga 450 në 700 l/s ndodh në vitin 2014 falë donacionit të Bashkimit Evropian. Ky zgjerim kishte për qëllim sigurimin e furnizimit të pandërprerë me ujë të pijshëm të konsumatorëve të Regjionit të Mitrovicës (Skenderaj, Vushtrri Veriu i Mitrovicës dhe Zveçani).

Rritja e vazhdueshme e kërkesave për ujë të pijes ndikon që të rriten kapacitetet prodhuese të ujit, prandaj në vitin 2016 në fshatin Balincë të Vushtrrisë përfundon ndërtimi i një Impianti të ri me një kapacitet prodhues prej 300 l/s, gjë që mjafton të furnizoj popullatën e Vushtrrisë me ujë të pijes.

Sot, Kompania Rajonale Ujësjellësi “Mitrovica” Sh. A. funksionon si Ndërmarrje Publike e cila në kuadrin e saj ka rreth 260 punonjës, të ndarë në tri Njësi Punuese Operative: Mitrovicë, Vushtrri dhe Skenderaj.

Furnizimin me ujë të pijes dhe mirëmbajtjen e ujërave të ndotura e bënë në tërë Regjionin: Mitrovica (J) me 69.866 banorë; Vushtrria me 63.473; Skenderaj me 53.277 banorë; Mitrovicën (V) me 11.987 banorë dhe Zveçanin me 7.235 banorë¹. Tremujori i dytë i vitit 2025 shënon një moment kyç në historikun operativ të kompanisë, pasi më 13.05.2025 ka filluar zyrtarisht marrja në menaxhim e komunave Mitrovicë e Veriut, Zveçan dhe Zubin Potok. Ky zgjerim ka përfshirë

¹ ASK “Vlerësimi i Popullsisë së Kosovës 2021”

sfida të konsiderueshme në aspektin e burimeve njerëzore, logjistikës teknike dhe kapacitetit financiar.

Pavarësisht këtyre sfidave, kompania ka arritur të vendosë një funksionim të qëndrueshëm dhe të suksesshëm në këto njësi të reja, duke rritur standardet e ofrimit të shërbimeve dhe duke përmirësuar treguesit e performancës në nivel të përgjithshëm. Ky progres tregon angazhim të lartë institucional dhe vullnet për përmbushje të misionit në të gjithë zonën e mbulimit.




Figura 1. Mbulueshmëria me shërbimet e ujësjellësit




Figura 2. Mbulueshmëria me shërbimet e kanalizimit

1.3 Objektivat Strategjike

Kompania Rajonale Ujësjetllësi “Mitrovica” operon si ndërmarrje e cila është llogaridhënëse tek Bordi i Drejtorëve, në përputhshmëri me principet e qeverisjes korporative.

Bordi i Drejtorëve, duke përfshirë Drejtorët Jo-ekzekutiv dhe Drejtorët/Zyrtarët Ekzekutiv, për të gjitha aktivitetet bazë, për një periudhë më afatgjatë (deri në 2027) ka përcaktuar qëllimet kryesore strategjike të cilat rrjedhin nga deklarata e nivelit të shërbimeve, përmbushja e të cilave synohet të arrihet përmes:

- Zgjerimit të zonës së shërbimit,
- Vetqëndrueshmëria financiare,
- Furnizimit të rregullt dhe të pandërprerë me ujë të pijes për të gjithë konsumatorët,
- Përmirësimit të vazhdueshëm të kushteve të punës për të gjithë të punësuarit.

Në planifikojmë që qëllimet strategjike afatgjata të lartë-përmendura të i realizojmë duke shfrytëzuar burimet e Kompanisë por dhe përmes mbështetjes nga institucionet e Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe donatorëve. Kompania ka paraparë përmbushjen dhe arritjen e objektivave strategjike për vitin 2025 si vijon:

- Zvogëlimin e shkallës së ujit të pa faturuar në 48 %
- Cilësinë e ujit të pijes sipas standardeve,
- Mirëmbajtjen dhe investimin në rrjetin e ujit dhe kanalizimit, me qëllim të ofrimit të një shërbimi sa më cilësor,
- Rritjen e shkallës së arkëtimit në 88 %
- Ngritjen e normës së punës në 1.20
- Rritjen e efikasitetit të stafit në 5.39

1.4 Analiza SWOT (Përparësitë, Dobësitë, Mundësitë dhe Rreziqet)

Për realizimin dhe arritjen e objektivave të parapara në këtë Plan, kompania ka përdorur analizën SËOT dhe metodologjinë e katër faktorëve; fuqitë, dobësitë, mundësitë dhe rreziqet. Këta faktorë kanë të bëjnë me rritjen e kompanisë, produkteve, shërbimeve dhe objektivave të kompanisë në konkurrencën e tregut. Dy nga këta faktorë janë të brendshëm: përparësitë dhe dobësitë dhe kanë

të bëjnë me ndikimin e vetë kompanisë në suksesin e saj, kurse dy faktorët tjerë: mundësitë dhe rreziqet paraqesin faktorët e jashtëm dhe të njëjtit varen nga ambienti i jashtëm i kompanisë. Për të arritur rezultatet e duhura KRUM do të tentoj të minimizoj dobësitë dhe rreziqet, duke përmirësuar në vazhdim teknologjinë e punës, avancuar/trajnuar stafin, qasje të vazhdushme proaktive ndaj borgjlinjeve, etj., e po ashtu të maksimizoj përparësitë dhe mundësit duke përmirësuar dhe zgjeruar në vazhdim shërbimin ndaj konsumatorit, duke ofruar mundësi zhvillimi profesional përmes punës praktike dhe punësimit për kuadrot e reja dhe profesionale.

1.4.1 Përparësitë:

- Përvoja shumëvjeçare në sektorin e ujësjellësit,
- Infrastrukturë të sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit,
- Operatori i vetëm i licencuar, konsumatorë të besueshëm, shitje të garantuar,
- Mbështetje nga Partnerët,
- Kapacitete të mjaftueshme prodhuese; Impianti në Shipol dhe Balinc.

1.4.2 Dobësitë:

- Teknologji e vjetërsuarë,
- Mosha e shtyrë e fuqisë punëtore,
- Konsumi i ujit në Veri dhe mopagesa e tij,
- Humbjet e mëdha teknike dhe komerciale,

1.4.3 Mundësitë:

- Zgjerimi i zonës së shërbimit dhe rritja e numrit të konsumatorëve,
- Zhvillimin e shërbimeve të reja lehtësuese për konsumatorin,
- Përmirësimin dhe zgjerimin e infrastrukturës së ujit dhe kanalizimit,
- Bashkëpunimi me kompanitë e sektorit të ujit si brenda ashtu edhe jashtë shtetit, dhe shkëmbimi i përvojave,
- Bazë e mirë ligjore për procedim të lëndëve të ndryshme në Gjykatë apo përmes Përmbauesve Privat,
- Infrastrukturë ligjore nga ana e Autoritetit Rregullator për Shërbimet e Ujit (ARRU),

1.4.4 Rreziqet:

- Ngritja e tensioneve sociale apo politike,
- Fatkeqësitë natyrore (tërmetet, vërshimet etj.),
- Trendi i ikjes së fuqisë punëtore si pasojë e liberalizimit të vizave për Kosovë,
- Gjendja e vështirë ekonomike dhe niveli i lartë i rasteve sociale në regjionin e Mitrovicës,
- Llogaritë e arkëtueshme të larta.

2. DEPARTAMENTI ADMINISTRATIV

2.1 Plani i Menaxhimit të personelit

K.R.U “Mitrovica”, në tërë procesin e përpunimit, shpërndarjes dhe ofrimit të ujit të pijshëm, si dhe menaxhimit të ujërave të ndotura, synon të mbajë një numër relativisht të qëndrueshëm të punëtorëve gjatë periudhës 2025–2027. Ky numër është paraparë të jetë nga 260 deri në 285 punëtorë.

Me marrjen në menaxhim të zonave të reja në Mitrovicën Veriore, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq, pritet një rritje prej rreth 120 pozitash shtesë, duke e çuar numrin total të punëtorëve në rreth 405 gjatë së njëjtës periudhë. Kjo rritje është e domosdoshme për të siguruar efikasitetin operativ të kompanisë dhe për të përmbushur kërkesat e zgjeruara të shërbimeve ndaj konsumatorëve në të gjithë zonën e mbuluar.

Burimet Njerëzore pranë K.R.U “Mitrovica”, aktivitetet e tyre i realizojnë në bazë të direktivave paraprakisht të përcaktuara në kuadër të Departamentit të Administratës me të vetmin qëllim-realizimin e vizionit dhe misionit të kompanisë. Burimet Njerëzore përfaqësojnë asetet më të vlefshme të një kompanie – njerëzit e saj, përfshirë dituritë, aftësitë dhe shkathtësitë që sjellin në çdo detyrë të veçantë. Përmes zhvillimit të vazhdueshëm profesional dhe avancimit të kompetencave, ne jo vetëm që sigurojmë performancë të lartë, por edhe kontribuojmë në rritjen dhe zhvillimin e qëndrueshëm të organizatës. Për një sukses të qëndrueshëm afatgjatë, janë thelbësore udhëheqja efektive dhe përfshirja aktive e të gjithë punonjësve. Kështu, investojmë në potencialin e njerëzve tanë, për të përmirësuar jo vetëm cilësinë e punës, por edhe kulturën e përgjithshme të kompanisë. Vizioni i Burimeve Njerëzore, është të ketë një sistem funksional dhe modern në harmoni të plote me zhvillimet e kohës.

- Njësia e Burimeve Njerëzore ka për qëllim të shtojë vlerën e kompanisë duke zbatuar strategji të avancuara dhe praktikave më të mira në fushën e menaxhimit të burimeve njerëzore. Kjo arrihet përmes:
- Zhvillimit dhe menaxhimit efektiv të punonjësve,
- Kompensimit dhe motivimit të punonjësve sipas vlerësimit të performancës,
- Zhvillimit të kompetencave që rrisin performancën individuale dhe organizative,

- Rritjen e inovacionit, kreativitetit dhe fleksibilitetit të nevojshëm për të rritur konkurrencën,
- Menaxhimi i zbatimit dhe integritit të teknologjisë përmes vlerësimit të nevojave, përmirësimit të sistemit, trajnimit të stafit dhe komunikimi me ta.

Njësia e Burimeve Njerëzore përballet gjithashtu me një sërë sfidash, si:

- Mungesa e Sistemit të Automatizuar: Të gjitha proceset aktualisht kryhen manualisht, duke rritur mundësinë e gabimeve dhe duke vonuar realizimin e aktiviteteve. Implementimi i një sistemi të automatizuar mund të përmirësojë efikasitetin dhe saktësinë e proceseve.
- Mungesa edhe e një Zyrtari në Kuadër të Burimeve Njerëzore: Aktualisht kem vetëm një zyrtar në këtë proces dhe mungesa e një zyrtar tjetër të dedikuar për burimet njerëzore, pa mundëson të menaxhojë në mënyrë efikase proceset e punës, trajnimeve dhe zhvillimit të stafit. Emërimi i një zyrtari të tillë mund të përmirësojë menaxhimin e burimeve njerëzore dhe të kontribuoni në zhvillimin e stafit.

Zhvillimi Profesional dhe Trajnimet

Burimet Njerëzore për K.R.U “Mitrovica” janë thelbësore për suksesin e kompanisë. Vlerësimi dhe çmimi i punës së stafit janë të rëndësishme për motivimin e tyre dhe për arritjen e objektivave kolektive. Angazhimi individual kontribuon në përmbushjen e qëllimeve të përbashkëta, duke forcuar kulturën e punës dhe duke rritur efikasitetin në ofrimin e shërbimeve. Në këtë aspekt, K.R.U “Mitrovica” planifikon që në vazhdimësi të investoj në ngritjen dhe zhvillimin e të punësuarve të saj, duke organizuar trajnime profesionale për ta. Roli i trajnimeve ka për qëllim të rekomandoj, hartoj, zhvilloj dhe zbatoj programe inovative të mësuarit dhe zhvillimit që mbështesin ciklin e plotë të punësimit, duke përfshirë hyrjen në kompani, zhvillimin e karrierës, mirëqenien, planifikimin e vazhdimësisë dhe zhvillimin e menaxhimit dhe lidërshiptit. Identifikon, zhvillon dhe ofron trajnime në përdorimin e burimeve dhe teknologjive online për të mbështetur zhvillimin organizativ. Trajnimit të vazhdueshëm të stafit do ti kushtohet një kujdes i veçantë ndërsa kosto e këtyre është paraqitur në buxhetin e përgjithshëm në kategorinë e shpenzimeve të personelit.

Identifikimi i masave për ngritjen e kapaciteteve të stafit të kompanisë përfshin këta hapa:

- Analizën e Nevojave
- Definimin e Qëllimeve
- Zhvillimin e Planit të Trajnimit
- Implementimin
- Vlerësimi dhe Monitorimi
- Përshtatjen dhe Përmirësimin

Tabela 1. Ndarja e Buxhetit e rishikuar sipas departamenteve për trajnime për vitin 2025

TRAJNIMI	BUXHETI/€
Departamenti Administrativ	4,000
Departamenti Teknik	4,800
IT	1,600
Cilësia e ujit	1,200
Departamenti Komercial	4,400
Departamenti Financiar	2,800
Njësia e Auditimit	1,200
Totali i Përgjithshëm	20,000




Figura 3. Struktura Organizative

Skema organizative e paraqitur në këtë kapitull ndjek modelin e piramidës, duke e strukturuar bartjen e kompetencave, përgjegjësi dhe autorizimeve në mënyrë hierarkike: nga niveli më i lartë drejt atij më të ulët, ndërsa kryerja dhe raportimi i detyrave realizohet në drejtim të kundërt, pra nga poshtë-lart.

Skema aktuale organizative është miratuar nga Bordi i Drejtorëve i KRU “Mitrovica” më 27.12.2022, ndërsa me rishikimin e Planit të Biznesit, kjo skemë është rishikuar dhe miratuar përsëri nga Bordi më 29.07.2025.

Ndryshimet në këtë skemë bëhen vetëm në raste të domosdoshme. Konkretisht, ky ndryshim është realizuar për shkak të zgjerimit të fushës së operimit me marrjen në menaxhim të komunave në pjesën veriore: Mitrovica Veriore, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq. Si rezultat KRUM do të bëhet me gjashtë njësi organizative ku i janë shtuar tri njësi të reja organizative si dhe Fabrika e Përpunimit të Ujit në Zubin Potok.

Nga kjo shihet se KRU "Mitrovica" Sh.A. udhëhiqet nga Bordi i Drejtorëve dhe Zyrtarët e Lartë: Kryeshefi Ekzekutiv , Auditori i Brendshëm, Zyrtaari Kryesor Financiar dhe Sekretari i Korporatës / Këshilltari i Përgjithshëm. Grupi udhëheqë i kompanisë përbëhet nga Kryeshefi Ekzekutiv, i mbështetur nga ekipi i tij i udhëheqjes, gjegjësisht nga Drejtorët e Departamenteve. Janë katër (4) Departamente Organizative në kuadër të Kompanisë si më poshtë:

1. Departamenti Administrativ
2. Departamenti Financiar
3. Departamenti Komercial dhe
4. Departamenti Teknik

KRU "Mitrovica" Sh.A. është një kompani publike nën administrimin e Qeverisë së Republikës së Kosovës, e cila njëkohësisht është edhe aksionare e Ndërmarrjes. Në lidhje me menaxhimin e burimeve njerëzore, bazohet në legjislacionin, Ligjet në fuqi në Kosovë , aktet nënligjore si dhe Rregulloret e brendshme të Kompanisë të hartuara në bazë të ligjeve në fuqi në Kosovë. Kompania numëron 257 punëtor të përqendruar në tri njësit e saja operative: Mitrovicë, Vushtrri dhe Skenderaj. Në tabelën në vazhdim kemi ilustruar hollësisht strukturën e punonjësve tanë.

Tabela 2. Niveli i edukimit/shkollimit të stafit të kompanisë 2025

NIVELI I SHKOLLIMIT/EDUKIMIT	Nr. i stafit	Përqindja
Edukimi pakualifikuar/fillor	24	9.34 %
Edukimi i mesëm/ lartë	175	68.09 %
Fakultet / Baçelor	37	14.40 %
Master	21	8.17 %
Totali	257	100%

Ndërsa tabela e mëposhtme pasqyron ndarjen e punonjësve në baza gjinore në kompani. Nga kjo shihet se vetëm 10.90 % e punonjësve janë gra, kurse 89.10% burra.

Objektivi për të rritur pjesëmarrjen e grave në kompani është një iniciativë jetike që kërkon një qasje të strukturuar dhe të mirë-planifikuar. Për të avancuar këtë objektiv, mund të përfshijmë disa hapa kyç duke u mbështetur në strategjinë e ndërmarrjes, përkrahja e politikave dhe praktikave të punësimit, adaptimit dhe integritit të burimeve njerëzore, duke zbatuar politikat e zhvillimit të tyre si dhe krijimi i hapësirave dhe mundësive të punëtorëve në mënyrë të vazhdueshme.

Tabela 3. Pjesëmarrja gjinore e stafit të kompanisë 2025

Gjinia	NUMRI I PUNONJËSVE	PËRQINDJA %
Gra	28	10.90 %
Burra	229	89.10 %
Total	257	100.00%

3. DEPARTAMENTI FINANCIAR

Departamenti i Financës në kompaninë tonë luan një rol kyç në sigurimin e qëndrueshmërisë financiare dhe përmbushjen e objektivave strategjike. Ai është përgjegjës për planifikimin financiar, kontrollin dhe analizimin e performancës financiare të kompanisë, duke u siguruar që të gjitha vendimet të bazohen në të dhëna dhe analiza të sakta. Përveç kësaj, Departamenti i Financës menaxhon likuiditetin, investimet dhe marrëdhëniet me institucionet financiare, tatimore dhe rregullatorët, duke siguruar një qasje efikase dhe të përgjegjshme në menaxhimin e burimeve financiare të kompanisë.

Departamenti Financiar, gjatë përgatitjes së Planit të rishikuar Biznesit, ka identifikuar dhe parashikuar sfidat kryesore që priten të shoqërojnë periudhën planifikuese. Menaxhmenti dhe BtD ka organizuar dhe kemi mbajtur një punëtori me qëllim identifikimin e rreziqeve dhe sfidave dhe analizën për muajt e kaluar dhe planifikimin për muajt e ardhshëm në mënyrë që rishikimi i planit të jetë sa më i sakt. Duke ndjekur këtë qasje proaktive, objektivat tona janë të fokusuar në sigurimin e qëndrueshmërisë financiare dhe përmirësimin e proceseve të brendshme të kompanisë. Objektivat tona kryesore përfshijnë:

- Rivlerësimin e aseteve (nëntokësore dhe mbitokësore) ,
- Provizionimin e llogarive të arkëtueshme,
- Përgatitjen e pasqyrave financiare në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Kontabilitetit (SNK),
- Raportimin financiar për qëllime tatimore në përputhje me legjislacionin aktual të Administratës Tatimore të Kosovës (ATK),

Autoriteti Rregullator i Ujit ka vendosur që për vitin 2025 të ketë ndryshim tarifar për një vit, duke rrit tarifën në këtë menyre:

Tabela 4. Tarifat për vitin 2024 dhe 2025

Nivelet e çmimeve nominale të tarifave (inflacioni i vlerësuar) (rrumbullakësuar)	Njësia	2024	2025
Ujë			
Shtëpiak - tarifa fikse mujore	EUR/kons/muaj	1.00	1.00

Shtëpiak -volumetrike	EUR/m3	0.36	0.39
Komercial-industrial-tarifa fikse mujore	EUR/kons/muaj	2.00	2.00
Komercial-industrial-volumetrike	EUR/m3	0.54	0.55
Institucional- tarifa fikse mujore	EUR/kons/muaj	2.00	2.00
Institucional-volumetrike	EUR/m3	0.54	0.55
Ujërat e zeza (vëllimi i ujit të konsumuar)			
Shtëpiak	EUR/m3	0.09	0.10
Komercial-industrial	EUR/m3	0.2	0.22
Institucional	EUR/m3	0.2	0.22
Tarifat komulative			
Shtëpiak (ujë dhe ujëra të ndotura)	EUR/m3	0.45	0.49
Jo-shtëpiak (ujë dhe ujëra të ndotura)	EUR/m3	0.74	0.77

Në rrethanat aktuale, planifikimi i saktë i parashikimeve financiare për një periudhë njëvjeçare përbën një sfidë të konsiderueshme, veçanërisht duke marrë në konsideratë faktin që viti financiar 2025 është ende në progres. Kjo sfidë e parashikimit lidhet ngushtë me pasigurinë e faktorëve të ndryshëm ekonomikë dhe mjedisorë, të cilët mund të kenë ndikim të ndjeshëm në performancën financiare të kompanisë. Megjithatë, të hyrat kryesore që do të përcaktojnë rezultatet financiare të vitit 2025 pritet të vijnë nga shitja e ujit. Ky është burimi kryesor i të ardhurave për kompaninë dhe pritet të mbetet një kontribues i qëndrueshëm në bilancin financiar. Përveç kësaj, të ardhurat do të gjenerohen edhe nga ofrimi i shërbimeve të ndryshme në rrjetin e ujit dhe kanalizimit. Këto shërbime përfshijnë mirëmbajtjen, riparimin dhe zgjerimin e infrastrukturës ekzistuese, të cilat jo vetëm që rrisin të ardhurat, por edhe kontribuojnë në përmirësimin e cilësisë së shërbimit ndaj klientëve.

3.1 Analiza e të Ardhurave

Në planifikimin financiar për vitet e ardhshme, kompania ka parashikuar që pjesa më e madhe e të ardhurave do të vijë nga shitja e ujit. Për vitin 2025, vlera e të hyrave të planifikuara është bazuar në tarifat e përcaktuara nga Autoriteti Rregullator i Ujit (ARRU).

Tabela 5. Të hyrat e planifikuara (me veri) të KRUM për vitet 2025– 2027

Emërtimi	2025	2026	2027
	(EUR)	(EUR)	(EUR)
Faturimi	6,678,432	6,812,001	6,880,121
Arketimi	5,309,448	5,468,731	5,632,793
% Arketimit	80%	80%	82%
Te hyrat nga shërbimet	30,000	30,000	30,000
% Arketimit per shërbime	100%	100%	100%

Norma e planifikuar e arkëtimit për vitin 2025 është paraparë të arrijë shkallën prej 80% të shumës së faturuar.

3.2 Analiza e Shpenzimeve

Planifikimi i shpenzimeve për vitin 2025 është zhvilluar me një qasje të kujdesshme dhe analitike, duke marrë në konsideratë një gamë të gjerë faktorësh që mund të ndikojnë në rritjen e shpenzimeve operative të kompanisë. Ky proces përfshin vlerësimin e mundshëm të rritjes së çmimeve të bazuar në normën vjetore të inflacionit, si dhe ndikimin e vjetërsisë së aseteve të kompanisë në kostot e mirëmbajtjes dhe zëvendësimit. Po ashtu theksojmë që shpenzimet janë rritur shkak i daljes në tregun e lirë të energjisë si dhe rritja e numrit të punëtorëve dhe shpenzimeve operative për Komunitatet veriore. Ky plan synon të sigurojë një menaxhim të qëndrueshëm financiar duke minimizuar rreziqet dhe duke optimizuar burimet për të garantuar qëndrueshmërinë e kompanisë në kushtet e luhatjeve të çmimeve dhe tregut në përgjithësi.

Të gjitha shpenzimet me ndryshime të rëndësishme janë pjesë e zërave të Shpenzimeve të jashtme kontraktuese dhe Shpenzimeve tjera.

Në vijim, paraqesim një plan të detajuar për disa nga elementet kryesore të shpenzimeve që do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në performancën e kompanisë për periudhën 2025-2027:

Tabela 6. Shpenzimet e planifikuara të KRUM për vitet 2025 – 2027

KATEGORIA	Vitet		
	Buxheti 2025	Projektuar 2026	Projektuar 2027
ARKËTIMI			
ARKTËTIMI I PËRGJITHSHËM	6,370,995	5,498,731	5,662,793
Arketimi nga sherbimet baze te ujit	5,309,448	5,468,731	5,632,793
Arketimi nga sherbimet	30,000	30,000	30,000
SHPENZIMET			
Shpenzimet e pagave	2,941,000	2,999,820	3,059,816
Pagesat per kompenzimin e oreve shtese 2021-2023	110,000	15,000	
Shpenzimet e energjise	1,850,000	1,854,625	1,856,480
Shpenzimet e karburanteve	42,000	42,105	42,147
Shpenzimet e Iber Lepenc-it	550,000	551,375	551,926
Shpenzimet e kemikaleve	100,000	100,250	100,350
Shpenzimet e mirembajtjes	88,000	88,220	88,308
Shpenzimet e komunikimit	10,360	10,386	10,396
Sherbimet e jashtme kontraktuese	287,990	150,000	150,150
Te tjera	70,142	70,317	70,388
SHPENZIMET E PËRGJITHSHME	6,049,492	5,882,098	5,929,962
	-		
Diferenca Arketim/Shpenzime	321,503	(383,367)	(267,169)
Investime Kapitale	(321,503)		

Tabela 7.Pasqyra e të ardhurave

Pasqyra e të Ardhurave		
	2024	2025
	€	€
Të hyrat		
Te hyrat nga shitja e ujit	5,162,384	6,189,490
Te hyrat nga sherbimet	30,556	25,424
Te hyrat nga subvencionet		1,031,547
Te hyrat nga donacionet(Te hyrat e shtyera)	1,368,801	1,393,801
Total te Hyrat	6,561,741	8,640,262
Kostoja e shitjes	678,111	650,000
Fitimi / (humbja) bruto	5,883,630	7,990,262
Shpenzimet e pagave	2,441,207	2,941,000
Shpenzimet e energjise	829,514	1,850,000
Shpenzimet e karburanteve	31,437	42,000

Shpenzimet e mirembajtjes	77,232	88,000
Shpenzimet e komunikimit	9,831	10,360
Sherbimet e jashtme kontraktuese	128,809	287,990
Te tjera	53,659	180,142
Borxhet e Fshira	313,356	200,000
Shpenzimet e zhvleresimit	2,496,895	2,516,895
Total shpenzimet	6,381,940	8,116,387
Fitimi / (humbja) operativ	(498,310)	(126,125)
Shpenzimet financiare		
Të ardhurat financiare		
Fitimi / (humbja) para tatimit	(498,310)	(126,125)
Shpenzimet e tatimit në fitim		
Fitimi / (humbja) i/e vitit	(498,310)	(126,125)
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse:		
Diferencat këmbimore nga përkthimi i pasqyrave	-	-
financiare te operacioneve të huaja, neto nga tatimi		
Të ardhurat tjera gjithëpërfshirëse të vitit	-	-
Gjithsej të ardhurat / (humbjet) gjithëpërfshirëse të vitit	(498,310)	(126,125)

3.3 Provizionimi i Llogarive të Arkëtueshme (LL/A)

Provizionimi i llogarive të arkëtueshme përfaqëson vlerën e përcaktuar gjatë kalkulimit të amortizimit (dëmtimit) të këtyre llogarive, në përputhje me kërkesat për metodën e kostos së amortizuar, sipas Standardeve Ndërkombëtare të Raportimit Financiar (SNRF 9). Çdo fundviti, ndërmarrja është e detyruar të vlerësojë zhvlerësimin e llogarive të arkëtueshme, duke testuar nëse ka ndonjë rritje apo ulje të vlerës së tyre. Në rast se vlerësimi tregon një rritje të vlerës së zhvlerësimit, kjo shumë do të regjistrohet si shpenzim në pasqyrën e të ardhurave; në të kundërtën, nëse vlera e zhvlerësimit reduktohet, ajo do të regjistrohet si të ardhura në pasqyrën e të ardhurave. Totali i provizioneve përfaqëson një kundër-llogari, e cila, gjatë paraqitjes në pasqyrat financiare, redukton vlerën e Llogarive të Arkëtueshme.

Vlera totale e LL/A është e grumbulluar ndër vite. Në vitin 2007 është njohur një provizion i LL/A në bazë të raportit nga Kompania rivlerësuese “GRANT THORTON”. Nga viti 2007 nuk është njohur më provizionimi i LL/A.

Synojmë që deri në fund të vitit 2025 të bëjmë analiza të mirëfillta në lidhje me aftësinë e inkasimit të arkëtueshmeve nga konsumatorët, në mënyrë që provizioni i njohur të jetë në përputhje me kërkesat që dalin nga Standardet Ndërkombëtare të Raportimit financiar SNRF 9.

3.4 Menaxhimi i Aseteve

Menaxhimi i asetëve të ujësjetës përfaqëson një aspekt kritik të operacioneve të kompanisë, duke përfshirë zhvillim të vazhdueshëm dhe përmirësim të proceseve të menaxhimit të tyre.

Parashohim intensifikim të aktiviteteve tona në hapat në vazhdim:

- Inventarizimin e të gjitha asetëve nëntokësore dhe mbitokësore,
- Vlerësimin monetar të asetëve dhe evidentimin e tyre në librat e kontabilitetit etj.

4. DEPARTAMENTI KOMERCIAL

Departamenti Komercial bënë organizimin, koordinimin dhe monitorimin e aktiviteteve në realizimin e shërbimeve me konsumatorët. Ky departament me seksionet e veta ka synim që në vazhdimësi të rrisë performancën e shërbimeve për konsumatorët. Në kuadër të përgjegjësi të veta si departament, siguron komunikimin e ndërsjellët me të gjitha departamentet tjera, ndërmerr të gjitha hapat e nevojshme që të gjitha ankesat dhe kërkesat e konsumatorëve t'i distribuoj në departamentet dhe seksionet tjera në domenin e të cilave barten përgjegjësit për realizimin e atyre kërkesave/ankesave të konsumatorëve.

Lexuesit në teren bëjnë leximin e ujëmatësve tek konsumatorët, ku njëkohësisht bëjnë shtypjen e faturave duke i dorëzuar të njëjten konsumatorit.

Ekipe të inspektoriatit (kontrollës), realizojnë kontrolla rutinë dhe të planifikuara tek konsumatorët si: leximin e ujëmatësve, lidhjet e paautorizuara, identifikimin e konsumatorëve ilegal, legalizimin e tyre, inkasimin e borxheve të vjetra, shkyçjen për mos pagesa të shërbimeve si dhe punë të tjera me të cilët ngarkohen nga ky departament, duke i zbatuar vendimet dhe rregulloret e brendshme të kompanisë. Njëkohësisht, pranon raportet e tyre dhe ndërmerr veprime të menjëhershme dhe urgjente.

Departamenti Komercial angazhimin kryesor e ka arritjen e objektivave strategjike të kompanisë me fokusin kryesor:

Objektivat kryesore

- Të ofrojë të gjitha shërbimet për konsumatorët sipas të gjitha standarteve të shërbimeve.
- Eliminimi i Konsumatorëve ilegal (keqepërdorusit),
- Leximin dhe faturimin e sakt të konsumit të ujit,
- Arkëtimin- Inkasimin e borxheve,
- Zgjidhja në kohë e kërkesave/ankesave të konsumatorëve,
- Eliminimi i Konsumatorëve pa matje(Paushall)

- Përditësimi i të dhënave të konsumatorëve etj.

4.1 Parashikimi i rritjes së numrit të konsumatorëve

Duke pasur parasysh trendin e zhvillimit Urban dhe planet për zgjerimin e rrjetit në zonat rurale nga analizat e viteve paraprake, po ashtu marrja në menaxhim të Komunave Veriore në vitin 2025 parashihet që numri i konsumatorëve të arrijë në 70,460.

Për vitin 2026 parashikohet që numri i konsumatorëve të arrijë deri në 74,883 në përgjithësi, me theks të veçantë në amvisëri, e thënë kjo për faktin se konsumatorët e ri të cilët do të kyçen në rrjetin e ujësjellësit vijnë nga objektet kolektive të cilët (në përgjithësi) i përkasin kategorisë së amvisërisë. Ndërsa në vitin 2027 numri i konsumatorëve parashihet që të arrijë në 76,374.

Tabela në vazhdim pasqyron të dhënat e parashikuara për numrin rritjen e konsumatorëve për periudhën planifikuese 2025 -2027, bazuar në të dhënat e viteve paraprake për vitet 2022 kishim 47,822 konsumator, në vitin 2023 kishim 49,725 dhe në vitin 2024 kemi 51,949, parashihet trendi i paraqitur në tabelë, ku pjesa më e madhe e rritjes së numrit të konsumatorëve është konsumatorë jo-rezident të cilëve iu faturohet vetëm tarifa e mirëmbajtjes gjë e cila nuk ndikon në rritjen e faturimit. Gjithashtu pritet të fillojë faturimi edhe në Komunat Veriore nga Tetori 2025.

Tabela 8. Numri i planifikuar i konsumatorëve sipas viteve

Numri i konsumatorëve	Viti 2025	Viti 2026	Viti 2027
KRUM	70,460	74,883	76,374

4.2 Leximi

Leximi i ujëmatësve do të bëhet në baza mujore në përjashtim të konsumatorëve të cilët nuk kanë kushte të mira për lexim gjatë sezonit dimëror.

Përveç leximit të ujëmatësve, lexuesi ka për obligim edhe:

- Lidhjen e kontratave të shërbimeve në mes të KRU Mitrovica Sh.A. dhe Konsumatorëve
- Evidentimin e keqpërdorimeve në teren,
- Identifikimin e konsumatorëve të rinj,

- Shpërndarjen e vërejtjeve tek konsumatorët që kanë obligime ndaj KRU “Mitrovica” Sh.A.,
- Zarfimi i faturave për konsumator, duke respektuar Ligjin për mbrojtjen e të dhënave ndaj konsumatorit etj.

4.3 Faturimi

Faturimi për konsumatorët do të jetë i rregullt dhe i saktë, bazuar në leximet e ujëmatësve nga ana e lexuesve tanë të trajnuar për këtë qëllim. Rritja e numrit të konsumatorëve është paraparë bazuar në objektet e reja në ndërtim e sipër kryesisht në qytet. Sfidë në vete gjatë vitit 2025 mbetet integrimi i Veriut duke përfshirë Mitrovicën Veriore dhe Zveçanin pjesë e cila ka ndikim të madh në të hyrat e Kompanisë. Rritja e sasisë së faturuar do të ketë ndikim edhe në rritjen monetare të faturimit, gjë që do të ndikoj në të hyrat e përgjithshme të kompanisë.

Tabelat në vazhdim paraqesin parashikimet për faturimin e sasisë së ujit në bazë të kategorive dhe njësive për vitin 2025. Një planifikim i tillë është bërë duke u bazur në trendin e lëvizjes së popullsisë ndër vite.

Tabela 9. Rekapitullimi i faturimit në m3 – KRU “ Mitrovica ” Sh.A.

Kategoria	Amvisëri	Biznes	Ekonomi	Institucione	Ndërkombtar	Veriu dhe Zvecani	TOTAL
Janar	519,770	54,048	10,057	47,378	10,900	400,000	1,042,153
Shkurt	515,454	52,061	9,916	47,291	10,900	400,000	1,035,622
Mars	526,516	53,658	10,151	47,442	10,900	400,000	1,048,667
Prill	537,389	54,405	10,280	47,529	10,900	400,000	1,060,503
Maj	552,760	55,768	10,430	47,631	10,900	400,000	1,077,490
Qershor	556,050	58,329	10,617	47,758	10,900	400,000	1,083,653
Korrik	574,090	60,500	10,989	48,011	10,900	400,000	1,104,490
Gusht	577,831	61,580	10,990	48,021	10,900	400,000	1,109,323
Shtator	557,861	56,280	10,617	47,770	10,900	400,000	1,083,429
Tetor	543,982	55,330	10,432	47,651	10,900	586,377	1,254,672
Nëntor	534,900	54,537	10,281	47,549	10,900	586,377	1,244,544
Dhjetor	551,277	56,265	10,617	47,769	10,900	586,377	1,263,205
Total	6,547,880	672,760	125,378	571,800	130,800	5,359,131	13,407,751

Tabela 10. Rekapitullimi – Plani i Faturimit në Euro për 2025 KRU “ Mitrovica “ Sh.A. (me Veriun dhe Zveçanin)

Kategoria	Amvisëri	Biznes	Ekonomi	Institucione	Ndërkombtar	Veriu dhe Zvecani	TOTAL
Janar	300,375	49,473	9,206	29,880	6,476	73,440	468,850
Shkurt	297,881	47,654	9,077	29,880	6,476	73,440	464,408
Mars	304,274	49,116	9,292	29,880	6,476	73,440	472,478
Prill	310,557	49,800	9,410	29,880	6,476	73,440	479,563
Maj	319,440	51,048	9,547	29,880	6,476	73,440	489,831
Qershor	321,341	53,392	9,718	29,880	6,476	73,440	494,247
Korrik	331,767	55,379	10,059	29,880	6,476	73,440	507,001
Gusht	333,928	56,369	10,060	29,880	6,476	73,440	510,152
Shtator	322,388	51,517	9,719	29,880	6,476	73,440	493,419
Tetor	314,367	50,647	9,549	29,880	6,476	312,910	723,829
Nëntor	309,119	49,921	9,411	29,880	6,476	312,910	717,717
Dhjetor	318,583	51,503	9,719	29,880	6,476	312,910	729,071
Total	3,784,020	615,821	114,767	358,555	77,710	1,599,690	6,550,563

4.4 Arkëtimi/Inkasimi

Në mënyrë që të jemi më pranë konsumatorit, KRU Mitrovica Sh.A. në vazhdimësi do të ofroj kushte dhe mundësi për konsumatorët e vetë duke iu ofruar mundësinë e pagesave në pikat e arkëtimit të vendosura nëpër qytete dhe njësi si dhe nëpërmes institucioneve mikro financiare, bankave dhe përmes zhvillimit të modulit e-KRUM (përmes së cilës platformë konsumatori do ketë qasje në llogarinë/kartelën e tij/saj 24/7 dhe do të kenë mundësinë e pagesës së obligimeve ndaj KRUM-së) etj.

Për periudhën 2025, KRU Mitrovica Sh.A planifikon ngritjen e faturimit të ujit së bashku me arkëtim. Gjithashtu pritet të fillojë arkëtimi edhe në Komunitat Veriore nga fundi i vitit 2025.

Për realizimin e objektivave të Departamentit Komercial do të vepohet si në vijim:

- Ndërmarrja e një fushate intensive në vetëdijesimin e qytetarëve (realizimi i së cilës do të bëhet përmes Zyrtarit për Marrdhënie me Publikun);
- Shpërndarja e fletushkave, broshurave informuese mbi faturimin, çmimin, përlllogaritjen e faturës(në arka) etj.

- Adresimi i borxheve të vjetra ku aktivitet kryesor do të vazhdoj, shkyçja, duke filluar me biznese e më pas amvisëria. Ky proces do të bëhet duke u respektuar rregulloret e ARRUsë.
- Informimin e vazhdueshëm për mundësitë e lidhjes së kontratave mbi ri programimin e borxheve të vjetra. Në raste të caktuara edhe iniciimin e procedurës përmbartimore.
- Tek rastet e keqpërdorimit iniciimi i procedurave gjyqësore

Tabela 11. Plani i Inkasimit për 2025 – KRU “Mitrovica” Sh.A. pa Komunitet Veriore

Kategoria	Amvisëri	Biznes	Ekonomi	Institucione	Ndërkombtar	TOTAL
Janar	319,043	49,473	9,206	29,880	6,476	414,078
Shkurt	316,763	47,654	9,077	29,880	6,476	409,850
Mars	322,606	49,116	9,292	29,880	6,476	417,370
Prill	328,349	49,800	9,410	29,880	6,476	423,915
Maj	336,468	51,048	9,547	29,880	6,476	433,420
Qershor	338,206	53,392	9,718	29,880	6,476	437,672
Korrik	347,735	55,379	10,059	29,880	6,476	449,529
Gusht	349,710	56,369	10,060	29,880	6,476	452,495
Shtator	339,163	51,517	9,719	29,880	6,476	436,753
Tetor	331,831	50,647	9,549	29,880	6,476	428,383
Nëntor	327,035	49,921	9,411	29,880	6,476	422,722
Dhjetor	335,685	51,503	9,719	29,880	6,476	433,262
Total	3,992,594	615,821	114,767	358,555	77,710	5,159,448

-Rritja e inkasimit në raport me faturimin është planifikuar në Inkasimin e borxheve të vjetra (të pa riprogramuara) dhe në riprogramimin e borxheve.

4.5 Rishikimi në Departamentin Komercial

Pas analizës së realizimit për TM1 dhe TM2 2025, aktivitetet kryesore të Departamentit Komercial janë duke u realizuar në përputhje me planin fillestar. Bazuar në të dhënat e performancës dhe parashikimet aktuale, nuk rekomandohet ndonjë ndryshim në objektivat apo treguesit e planifikuar për këto aktivitete.

Tabela 12. Tabela e vlerësimit të konsumatorëve

Aktiviteti Komercial	Objektivi në Plan	Realizimi Deri më Tani	Ndryshimi i Planifikuar	Arsyetimi
Parashikimi i rritjes së numrit të konsumatorëve	Rritje e numrit të konsumatorëve të rinj me 2,000	Tejkalim i Planit 14.25%,	Rritje e numrit të konsumatorëve	Vlera e rishikuar 70,460

Faturimi m³	Faturim për 6-mujorin e pare të vitit 2025, 3,947,027m³	Tejkalim i Planit 2.77%, 4,056,580.99m³	Nuk ndryshon për Mitrovicë Jugore, Vushtrri dhe Skenderaj	Nuk ka devijime në ekzekutim. Vetem faturimi per Veri
Faturimi €	Faturim për 6-mujorin e pare të vitit 2025, 2,296,478€	Tejkalim i Planit 4.92%, 2,409,653.44€	Ndryshon për të pasqyruar zhvillimet në Komunat Veriore	Vlera e rishikuar 6,678,432 euro
Arkëtimi/Inkasimi	Arkëtimi/Inkasimi për 6- mujorin e pare të vitit 2025, 2,414,564€	Norma aktuale 98.39% 2,375,777.73€	Ndryshon për të pasqyruar zhvillimet në Komunat Veriore	Norma është në linjë me planin e miratuar. Arkëtimi për Komunat Veriore 150,000 euro

Kompania planifikon fillimin e faturimit në Komunat Veriore nga muaji Tetor i këtij viti. Tabela që shihni më posht bazohet në numrin e konsumatorëve të marr nga ZRRE si të vetmin informacion zyrtar që kemi për atë pjesë edhe pse ne ju jemi drejtuar Komunave për ofrimin e informacioneve mirëpo nuk kemi pranuar dicka të till ende. Nuk kemi ndarje të konsumatorëve për komuna specifike vetëm si total. Faturimi për Veriun ka efekt në pasqyrën kryesore të performancës duke rrit faturimin në shitje me pakicë dhe duke ulur faturimin për furnizimin me ujë me shumicë.

Tabela 13 . Të dhënat mbi konsumatorët shtëpiak dhe jo - shtëpiak

	Nr i konsumatorëve	Sasia m3/muaj	Vlera euro per tre muaj Pa TVSH
Konsumatorët shtëpiak	15,000	495,000	727,650
Konsumatorët jo-shtëpiak	2,769	91,377	211,081
Totali:	17,769	586,377	938,731

5. CILËSIA E UJIT

Qëllimi i njësive të cilësisë së ujit të pijshëm është të sigurojë që uji që përdoret për konsum njerëzor të jetë i sigurt, pa ndotje dhe i përshtatshëm për shëndetin e njeriut. Ky qëllim përfshin përmbushjen e standardeve të caktuara të cilësisë së ujit, që sigurojnë se uji nuk përmban ndotës ose substanca që mund të dëmtojnë shëndetin.

Konkretisht, qëllimet kryesore të cilësisë së ujit të pijshëm janë:

- Sigurimi i Shëndetit Publik: Uji i pijshëm duhet të jetë i lirë nga mikroorganizmat patogjenë (si bakteret, viruset dhe parazitët), substancat kimike të dëmshme (si metalet e rënda, pesticide dhe kimikate të tjera), si dhe çdo përbërës tjetër që mund të përbëjë rrezik për shëndetin.
- Mbajtja e Vlerave Sensorike të Përshtatshme: Uji duhet të ketë shije, erë dhe ngjyrë të këndshme për t'u konsumuar. Parametrat fizikë, si turbullirësia dhe pH-ja, duhet të jenë në nivele që nuk ndotin perceptimin e ujit si të sigurt.
- Ruajtja e Standardit të Cilësisë për Përdoruesit: Për të siguruar besimin e konsumatorëve dhe për të promovuar shëndetin, është e rëndësishme që uji i pijshëm të përmbushë standardet dhe rregullat e përcaktuara nga organizatat kombëtare dhe ndërkombëtare, si Organizata Botërore e Shëndetësisë (OBSh).
- Parandalimi i Sëmundjeve: Një qëllim kryesor i ruajtjes së cilësisë së ujit të pijshëm është parandalimi i sëmundjeve hidrike, si dizenteria, kolera dhe infeksionet e tjera që mund të shkaktohen nga konsumimi i ujit të kontaminuar. Kontrolli i parametrave biologjikë është thelbësor për këtë qëllim.
- Furnizimi i qëndrueshëm me ujë të sigurt: Një aspekt tjetër i qëllimit të cilësisë së ujit është garantimi që uji i pijshëm të jetë i qasshëm dhe i sigurt për të gjithë konsumatorët në çdo kohë, duke ruajtur edhe burimet ujore nga ndotjet për të siguruar furnizimin e qëndrueshëm.

Në përmbledhje, qëllimi kryesor i cilësisë së ujit të pijshëm është të sigurohet që çdo individ ka qasje në ujë të sigurt dhe të pastër për të mbrojtur dhe përmirësuar shëndetin e përgjithshëm dhe cilësinë e jetës.

5.1 Procesi aktual i monitorimit të ujit të pijshëm

Analizat e ujit me parametrat si era, shija, turbiditeti, ngjyra, shkalla Co-Pt, vlera e PH, shpenzimi i KMnO_4 , klori i lirë, kloruret, amoniaku, nitritet, nitratet, hekuri, mangani, alumini dhe përçueshmëria elektrike. bëhen çdo katër orë (08:00; 12:00; 16:00; 20:00; 24:00). Të gjitha rezultatet e analizave të punuara në laboratorët e ITU-ve deri më tani janë brenda kufijve të lejuar për ujë të pijes në bazë të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.10/2021 për Cilësinë e Ujit të Destinuar për Konsum Njerëzor. IKSHPK-ja përcjell dhe monitoron cilësinë e ujit të pijes nga ana fiziko-kimike dhe bakteriologjike përmes analizave, të cilat i zhvillon me marrjen e mostrave në lokacione të ndryshme duke përfshirë impiantet dhe pika të caktuara në të gjithë rajonin.

5.2 Plani për monitorimin e ujit të pijshëm

Sektori i cilësisë ka për detyrë të vërtetojë dhe sigurojë kualitetin e ujit që ofrohet konsumatorëve, duke parandaluar problemet dhe gabimet gjatë trajtimit të ujit deri sa të arrijë tek konsumatori. Objektivat kryesore të këtij sektori janë:

- Monitorimi i ujit në burimet e përdorura nga KRU Mitrovica.
- Sigurimi i cilësisë së ujit të trajtuar deri tek konsumatori.

Në përputhje me Udhëzimin Administrativ (QRK) Nr.10/2021, sektori i cilësisë vepron në mënyrë të pavarur nga impiantet për të shmangur ndikimet dhe për të rritur besueshmërinë e rezultateve të kontrollit. Duke mbështetur këtë udhëzim, KRU Mitrovica planifikon:

- Rifunksionalizimin e një pjese të objektit në fabrikën e vjetër në Shipol për Sektorin e Cilësisë dhe laboratorin qendror.
- Abonimin me LIMS (Laboratory Information Management System) për ruajtjen e të gjitha të dhënave laboratorike, nga mostrimi deri tek rezultatet e analizave.
- Furnizimin me pajisje laboratorike dhe material shpenzues.
- Akreditimin e laboratorit për disa parametra të cilësisë së ujit.
- Monitorimin e ujit në rajon përmes marrjes së mostrave në pika të ndryshme nga stafi i laboratorit.

Parametrat që nuk kanë ndryshuar për një periudhë të caktuar nuk është e nevojshme të analizohen shpesh. Për këtë arsye, uji në impiante mund të analizohet çdo tetë orë, ndërsa parametrat si pH, temperatura, nitratat, amoniaku, oksigjeni, turbullira dhe klori do të monitorohen vazhdimisht përmes sistemit online SCADA. Në rast të analizave të dyshimta, sektori i cilësisë do të punojë me orar të zgjatur.

5.3 Investimet e planifikuara për departamentin e cilësisë

- Është nënshkruar kontrata me operatorin ekonomik që ka fituar tenderin për donacionin nga organizata SKAT, në vlerë prej rreth 50,000 €, për furnizimin me pajisje laboratorike për analizat fiziko-kimike dhe bakteriologjike, në kuadër të laboratorit të KRU Mitrovica. Gjithashtu, si pjesë e këtij donacioni është përfshirë edhe angazhimi i një eksperti të jashtëm për procesin e akreditimit, në vlerë prej afërsisht 3,000 €. Aktualisht jemi në pritje të ardhjes së pajisjeve. Megjithatë, për të përmbushur të gjitha kriteret teknike të nevojshme për akreditim, kemi identifikuar nevojën për disa mjete plotësuese, për të cilat kërkojmë rishikimin dhe përfshirjen në planin e biznesit:
- Veturë për marrjen e mostrave në terren, e domosdoshme për punën laboratorike të lëvizshme dhe për përmbushjen e standardeve të akreditimit – vlera e parashikuar: rreth 20,000 €
- Reagjentë kimikë si dhe reagjentë bakteriologjikë, për kryerjen e analizave laboratorike të vazhdueshme – vlera e parashikuar: rreth 10,000 €
- Kontratimi i një kompanie të licencuar për kalibrim ekstern të pajisjeve të laboratorit
- Angazhimi me kontratë i një mikrobiologu specialist me kohë të pjesshme në laboratorin mikrobiologjik
- Invertarizimi i laboratorit në Shipol: rreth 20,000 €
- Akreditimi i laboratorit qendror
- Sigurimi i uniformave dhe veshmbathjeve për personel
- Ditar të punës
- Sigurimi i një veture adekuate për nevoja të terrenit e shfrytëzuar për marrjen e mostrave të ujit në nivel të kompanisë
- Enë të ndryshme laboratorike (çelçurina, pipeta, termometër etj)
- Sigurimi i reagjentëve fiziko-kimik dhe mikrobiologjik

- Gjithashtu shpenzimet rriten dukshëm pasi në monitorim është futur edhe Mitrovica e veriut, Zubin Potoku dhe Zveqani. Për momentin ato monitorohen nga IKSHPK me kontratë si laborator i akredituar pasi ne nuk e kemi akredituar akoma laboratorin.

Kontrollimet Shëndetësore

Kontrollimet e rregullta shëndetësore të stafit të punëtorve të cilët punojnë në laborator.

5.4 Trajnimi i stafit të punëtorëve

Planifikohet trajnimi i stafit në këto programe:

1. Menaxhimi i rrezikut dhe siguria në vendin e punës në laborator
2. Trajnim profesional për aftësimin e stafit për analizimin e ujrave të pijshëm
3. Trajnim për analizat mikrobiologjike
4. Trajnim për gjurmueshmërinë, mledhjen dhe ruajtjen e të dhënave në laborator
5. Trajnim profesional për procesin e mostrimit dhe përgatitjen e mostrës.

Totali i shpenzimeve të planifikuara pesëdhjetëmijë (50,000) euro.

5.5 SCADA

Shkurtesa “SCADA” në gjuhën angleze qëndron për “Supervisory Control and Data Acquisition”. Në gjuhën shqipe kjo do të thotë: “Kontrolli Mbikëqyrës dhe Përvetësimi/mbledhja e të Dhënave”.

SCADA, pra nënkupton një sistem të automatizuar kompjuterik, ku kontrolli, mbikëqyrja dhe manovrimi/manipulimi i proceseve bëhet nga dhoma operuese përmes operatori/ dispeçerit.

Operatori/dispeçeri kujdestar përmes dhomës operuese respektivisht sistemit SCADA monitoron këto procese, dhe jo vetëm:

- Hyrjen e ujit të papërpunuar ,
- Stacionin e pompimit (pompat sekuenciale) ,
- Nivelin e turbiditetit (turbullshmërisë) së ujit ,
- Sasinë e klorit në fazën e para klorinimit dhe/ose sasinë e ozonit (operimi me ozon) ,
- Nivelin e PH-së ,
- Sasinë e kimikateve në ujë: ferro klorurin dhe alumin sulfatin ,

- Procesin e filtrimit dhe pastrimit të fushave filtruese ,
- Sasinë e klorit në proces: klorimi kryesor ,
- Nivelin e ujit në rezervuarët kryesor ,
- Nivelin e rezervave të kimikateve në tanke ,
- Sasinë e prodhuar të ozonit ,
- Sasinë e ujit për riciklim (nga pastrimi i filtrave) ,
- Sasinë e ujit i cili del nga procesi i trajtimit për shpërndarje .

Vlen të ceket se sistemi SCADA evidenton dhe alarmon për çdo anomali/parregullsi që ndodh në cilëndo pjesë të procesit.

5.6 Analizat fiziko-kimike

Në laboratorët e ITU-ve të KRU, "Mitrovica" bëhen analizat fiziko-kimike të ujit të pa trajtuar dhe ujit të trajtuar por jo ato bakteriologjike. Momentalisht analizohet vetëm uji i impianteve, këto analiza bëhen herë në çdo ditë pune nga stafi i laboratorit.

Në këto analiza përfshihen:

- Era, shija, turbiditeti, ngjyra, shkalla Co-Pt, vlera e PH, shpenzimi i KmnO_4 , klori i lirë, kloruret, amoniaku, nitritet, nitratet, hekuri, mangani, alumini dhe përçueshmëria elektrike.
- Ndërkaq parametrat si: pH, klori i lirë, temperatura, përçellshmëria elektrike përcillen 24 orë nga sistemi SCADA.

Të gjitha analizat e punuara në laboratorët e ITU-ve janë brenda kufijve të lejuar për ujë dhe në bazë të Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr.10/2021 për Cilësinë e Ujit të Destinuar për Konsum Njerëzor.

Laboratori ynë është i pajisur numër të vogël të aparaturës për përcaktimin e parametrave të nevojshëm bakteriologjik, dhe shumë prej pajisjeve janë në mungesë andaj pjesa e parametrave bakteriologjik nuk është punuar në laboratorët tona. Mirëpo me ardhjen e pajisjeve të tjera njëkohësisht edhe të reagjentëve bakteriologjik, shumë shpejt laboratorit mikrobiologjik do të hyjë në funksion.

5.7 Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik

Instituti Kombëtarë i Shëndetit Publik, dega në Mitrovicë, përcjell dhe monitoron cilësinë e ujit të pijes nga ana bakteriologjike përmes analizave të cilat i zhvillon përmes marrjes së mostrave në lokacione të ndryshme. IKSHP në bazë të rregullt mujore raporton tek ne, ndërsa në rast të ndonjë analize të dyshimtë IKSHP përsëritë mostrën e caktuar dhe na njofton për gjendjen reale të cilësisë së ujit në Mitrovicën Jugore, Vushtri, Skenderaj, Mitrovicën veriore, Zubin Potok dhe Zveqan.

5.8 Burimet e ujit

Duke pasur parasysh faktin se KRU “Mitrovica” Sh.A. furnizohet me ujë të papërpunuar nga “Ibër Lepenci”, mbrojtja e burimeve të ujit është në kompetencën e tyre. Sidoqoftë, kompania është vigjilente dhe kujdeset që të monitoroj situatën e pjesës ku bëhet kaptimi i ujit në fshatin Lushtë dhe Balinc. Nga ana tjetër jemi në përpjekje që të sigurojmë objektet tjera përcjellëse si: rezervarët e ujit, stacionet e pompimit etj, duke siguruar rrethoja mbrojtëse përreth me qëllim të parandalimit të depërtimit të kafshëve në zonën mbrojtëse të tyre.

6. DEPARTAMENTI TEKNIK

6.1 Hyrje

Departamenti teknik i KRU-Mitrovica SH.A përfshin të gjitha aktivitetet me qëllimin e vetëm për të ofruar furnizim të vazhdueshëm dhe të sigurt me ujë të pijshëm për konsumatorët, si dhe mirëmbajtjen e kanalizimit. Objektivat strategjike të Departamentit Teknik janë:

- **Cilësia e Ujit:** Sigurimi që uji i trajtuar dhe i shpërndarë të plotësojë standardet e cilësisë së ujit të pijshëm dhe të shëndetit publik.
- **Rritja e Efikasitetit Operacional:** Optimizimi i procesit të trajtimit dhe shpërndarjes së ujit për të ulur kostot dhe për të rritur efikasitetin.
- **Zhvillimi i Infrastrukturës:** Planifikimi dhe ndërtimi i infrastrukturës së nevojshme për të mbështetur rritjen e popullsisë dhe kërkesat për ujë dhe shërbime.
- **Inovacioni dhe Teknologjia:** Përmirësimi i proceseve teknike dhe përfshirja e teknologjive të reja për të rritur efikasitetin e përgjithshëm.
- **Menaxhimi i Riskut:** Identifikimi dhe menaxhimi i rreziqeve që mund të ndikojnë në furnizimin dhe cilësinë e ujit.
- **Përputhshmëria me Rregulloret:** Sigurimi që të gjitha aktivitetet teknike përputhen me rregulloret, planet dhe standardet ligjore.
- **Zvogëlimi i Humbjeve të Ujit:** Zbatimi i planit strategjik për reduktimin e humbjeve të ujit të pafaturuar.

Këto objektiva rrjedhin nga objektivat strategjike të ndërmarrjes, e që janë rritja e qëndrueshme, kënaqëshmëria e konsumatorëve dhe mbrojtja e mjedisit.

6.1.1 Menaxhimi me komunat Veriore

Pas nënshkrimit të marrëveshjes me komunat në pjesën veriore të Kosovës, Kompania Rajonale e Ujësjetillës "Mitrovica" ka filluar operimin aktiv në këtë zonë, me fokus të veçantë në përmirësimin e infrastrukturës ekzistuese, sigurimin e furnizimit të qëndrueshëm me ujë të pijshëm dhe ofrimin e shërbimeve të standardizuara për qytetarët.

Kompania Rajonale e Ujësjiellësit 'Mitrovica' Sh.A, në përputhje me zgjerimin e përgjegjësi në komunat veriore, shpreh përmes këtij dokumenti gatishmërinë teknike, menaxheriale dhe operative për të mbuluar zonën e re të shërbimit.

1. Funksionimi Aktual

Aktualisht kompania jonë ka funksionalizuar strukturën organizative sipas planit operativ të miratuar. Janë të hapura konkurset për pozitat e parashikuara në këtë plan, të cilat do të përforcojnë më tej kapacitetin e shërbimit në Mitrovicë të Veriut, Zveçan, Zubin Potok dhe Leposaviq.

2. Fabrika e Ujit në Zubin Potok

Fabrika e ujit në Zubin Potok operon me ndërtime 24-orëshe, me përfshirjen e tri kompanive rajonale:

- Dy ndërtime mbahen nga KRU Mitrovica,
- Një nga KRU Prishtina,
- Një nga KRU Gjakova.

Ekipet operationale përbëhen nga operatorë teknikë, laborantë për kontrollin e cilësisë së ujit dhe dozatorë për menaxhimin e kimikateve. Menaxheri i fabrikës së Shipolit është përgjegjës për mbikëqyrjen e operimit, ndërsa mbështetja teknike sigurohet nga ekipi i elektromakinerisë së KRU Mitrovica.

Deri më tani, funksionimi është realizuar pa ndonjë pengesë operationale.

3. Menaxhimi i Njësive në Veri

ITU-Zubin Potok dhe njësitet operative të zonave Veriore do të menaxhohen nga stafi i paraparë sipas organogramit të propozuar. Menaxhimi i operationeve në komunat veriore bëhet në mënyrë të koordinuar nga një koordinator i caktuar për zonën e veriut, nga shefi I rrjetit dhe ekipet e mirëmbajtjes së rrjetit të ujit.

Ndërkohë, mirëmbajtja e rrjetit të kanalizimit për këtë zonë mbulohet nga ekipi teknik që operon nga jugu.

Operimi i plotë dhe normal i njësive në komunat veriore pritet të fillojë së shpejti, pasi kompania ka hapur tashmë konkurset për të gjitha pozitat e parashikuara në planin operativ. Me përfundimin e procesit të rekrutimit, strukturat e reja do të jenë të gatshme për të marrë përgjegjësitë sipas funksioneve përkatëse, duke siguruar kontinuitet dhe efikasitet në ofrimin e shërbimeve ndaj qytetarëve në zonën e re të menaxhimit.

Në përfundim, KRU 'Mitrovica' Sh.A konfirmon se posedon kapacitete të mjaftueshme teknike, menaxheriale dhe njerëzore për të ofruar shërbime të qëndrueshme në zonën e re të menaxhimit, në përputhje me standardet dhe kërkesat e përcaktuara nga ARRU dhe institucionet përkatëse.

6.2 Humbjet e ujit

Zvogëlimi i humbjeve të ujit përfaqëson një nga sfidat më të mëdha për kompaninë, duke qenë se mbi gjysma e ujit të trajtuar dhe të shpërndarë në sistem mbetet e pafaturuar (55% çdo vit). Kjo përfshin humbje fizike, si rrjedhjet nga gypat, dhe humbje komerciale, si gabimet në matje dhe lidhjet(shfrytëzimet)ilegale, të cilat janë faktorët kryesorë që ndikojnë në këtë fenomen. Ky nivel i lartë i humbjeve jo vetëm që shkakton humbje financiare për kompaninë, por ndikon edhe në cilësinë e furnizimit për konsumatorët, duke krijuar ndërprerje në furnizim dhe duke rrezikuar cilësinë e ujit, që mund të përbëjë një kërcënim për shëndetin e popullatës.

Për të përmbushur objektivin e zvogëlimit të humbjeve të ujit dhe për të përmirësuar efikasitetin operacional, kompania do të përqendrohet në aktivitetet e mëposhtme:

- **Identifikimi dhe riparimi sistematik i rrjedhjeve** dhe monitorimi i rrjetit distributiv në kuadër të sektorëve të përcaktuar (Zonat e Matura-DMA).
- **Ndërtimi, mirëmbajtja dhe mbrojtja e sistemit të ujësjellësit dhe kanalizimit** për të garantuar furnizim të sigurt dhe të vazhdueshëm.
- **Mbulimi i plotë i konsumatorëve me ujëmatës**, në koordinim me departamentin komercial, për të siguruar matje të saktë dhe të drejtë të konsumit.
- **Rritja e efikasitetit operativ** për të optimizuar proceset dhe për të ulur kostot e lidhura me humbjet e ujit.

Këto aktivitete kontribuojnë në përmbushjen e objektivave strategjike të ndërmarrjes, si zvogëlimi i humbjeve të ujit, përmirësimi i efikasitetit operacional dhe rritja e cilësisë së furnizimit, duke u përpjekur për një furnizim të qëndrueshëm dhe cilësor për konsumatorët.

6.3 Mbulueshmëria me shërbime

Duke u bazuar në të dhënat e Agjencisë Statistikore të Kosovës për popullsinë, menaxhmenti i kompanisë vlerëson se deri në vitin 2026, do të ketë një rritje të numrit të ekonomive familjare (konsumatorëve shtëpiak) në regjion. Kjo rritje do të rezultojë në një kërkesë të shtuar për ujë të pijshëm. Me kapacitetet aktuale të Impianteve të Trajtimit të Ujit në Shipol dhe Balinc, kompania është e përgatitur për të përballuar rritjen e pritur të kërkesës për ujë të pijshëm. Kapacitetet e këtyre impianteve mund të menaxhojnë me efikasitet furnizimin e nevojshëm për konsumatorët e rinj e atë gjithmonë duke siguruar një cilësi të lartë të shërbimit të ujësjellësit dhe kanalizimit. Këto hapa strategjikë do të ndihmojnë KRU Mitrovica Sh.A. që të sigurojë shërbime të cilësisë së lartë për të gjithë regjionin dhe të përmbushë nevojat në rritje të konsumatorëve të saj. Duke u bazuar në të dhënat e lartpërmendura parashikohet se deri në fund të vitit 2026 përqindja e mbulimit me shërbime të furnizimit me rrjet të ujësjellësit dhe kanalizimit do të jetë :

- Me furnizim me ujë , mbi 95 % e regjionit të Mitrovicës,
- Me rrjet të kanalizimit mbi 85 % dhe
- Trajtimi i ujërave të ndotura do të rritet deri 65 %, marrë për bazë planifikimin e ndërtimit të Impiantit të ri për Trajtimin e Ujërave të Ndotura (ITUN) dhe kolektorëve kryesor dhe rrjetit sekondar të ujërave të ndotura që do të ndërtohet në Komunën e Mitrovicës dhe Vushtrrisë.

6.4 Zbulimi i rrjedhjeve

Me qëllim të realizimit të objektivave të ndërmarrjes, gjatë vitit 2025 do të intensifikojmë kërkimet në zbulimin e rrjedhjeve sidomos gjatë orëve të natës kur nëpër lokacione të ndryshme nuk ka zhurmë, konsumi i ujit është shumë i ulët, ndërsa presioni i ujit në tubacion i lartë gjë që e bënë më të lehtë zbulimin e rrjedhjeve nëntokësore, përmes pajisjeve zbuluese akustike. Ky aktivitet do të kryhet përmes caktimit të zonave tek të cilat dyshohet se ka shpenzim të lartë të ujit të pijes.

Aktivitetet për identifikimin e rrjedhjeve do të zhvillohen gjatë gjithë vitit, por vëmendja kryesore do të ndodhë gjatë muajve Prill – Shtator pasi që intervenimet në rrjetë janë më të lehta për t'u sanuar.

6.5 Prodhimi & Operimi në Impiante

Impiantet për trajtimin e ujit në Shipol të Mitrovicës dhe Balinc të Vushtrrisë parashihet që të vazhdojnë operimin e tyre normal. Impiantet e trajtimit të ujit, të gjithë qytetarëve të vet u garanton ujë cilësor, gjë e cila vërtetohet në bazë të analizave që kryhen në ITU-të në Shipol dhe Balinc si dhe verifikohen nga Instituti Kombëtar i Shëndetit Publik (IKSHP). Përmes synimeve tona të lartcekura, planifikojmë uljen e kapaciteteve tona prodhuese duke mos cenuar në asnjë moment cilësinë e shërbimit ndaj konsumatoreve.

Tabela 14. Kapacitetet prodhuese të ITU-ve

Impiantet për trajtimin e ujit (ITU)	2025		2026		2027	
	Maksimal	Planifikim	Maksimal	Planifikim	Maksimal	Planifikim
ITU në Shipol	700 l/s	610 l/s	700 l/s	590 l/s	700 l/s	590 l/s
ITU në Vushtrri	300 l/s	230 l/s	300 l/s	190 l/s	300 l/s	190 l/s
ITU Zubin Potok ²	160l/s	150l/s	160l/s	150l/s	160l/s	150l/s
ITU Leposaviq ³	60l/s	50l/s	60l/s	50l/s	60l/s	50l/s
Total	1220 l/s	1040 l/s	1220 l/s	980l/s	1220 l/s	980l/s

Tabela 15. Prodhimi real për 6 mujorin e parë të këtij viti sipas raportimeve.

ITU	2025					
	Maksimal	I planifikuar	Realizuar	Devijimi	Rishikuar	Arsyetim
SHIPOL	700 l/s	590 l/s	627.76l/s	+37.6 l/s, +6.4%	590l/s	Objektivi është duke u realizuar
VUSHTRRI	300 l/s	190 l/s	236.21l/s	+46.21l/s, +24.32%	190l/s	Kemi një tejkalim prej objektivit
Totali	1000 l/s	780 l/s	863.97l/s	+83.97l/s, +10.76%	780 l/s	Kemi devijim/ tejkalim

² Kapaciteti prodhues për vitin 2025 vetëm gjashtë mujori i dytë-ITU-Zubin Potok

³ Kapaciteti prodhues për vitin 2025 vetëm gjashtë mujori i dytë- ITU-Leposaviq

Pikat kryesore të arsytimit:

1. Planifikimi konservativ për 2025 krahas 2024:

Në Planin e Biznesit për vitin 2025 është bërë një ulje e planifikimit për prodhim prej **60 l/s më pak** se në vitin 2024, ndonëse kërkesat nuk janë zvogëluar. Kjo ulje ishte rezultat i:

- Nevojës për rritje të efikasitetit dhe kursim energjie,
- Parashikimeve që një pjesë e humbjeve në rrjet do të minimizoheshin,
- Objektivit për të balancuar kostot operacionale me të ardhurat nga konsumatorët.

2. Rikthim i pjesshëm ndaj kërkesës reale të konsumatorëve:

Kërkesat për ujë në terren – si për konsum shtëpiak, institucional dhe industrial – nuk kanë rënë. Përkundrazi, në disa zona është vërejtur rritje. Tejkalmi është përgjigje ndaj nevojave reale që nuk ishin plotësisht të parashikuara në plan.

Tabela 16. Prodhimi real për njësi Janar- Qershor 2025

Përshkrimi	Mitrovicë	Vushtrri	Skënderaj	Mitrovicë e Veriut dhe Zvecan	Total
Prodhimi m3	5,658,123	3,673,614	1,337,508	2,767,280	<u>13,436,525</u>

Vlerësim dhe arsytim për tejkalimin / qëndrueshmërinë krahasuar me planin

Ulja në planifikim krahas 2024:

Planifikimi për vitin 2025 ka paraparë një **ulje prej 15.16%** krahasuar me sasinë e prodhuar në vitin 2024. Kjo ulje ka pasur për synim kursimin energjetik, optimizimin e burimeve dhe zvogëlimin e humbjeve në rrjet.

Realizimi për Janar–Qershor 2025:

Në 6 muajt e parë të vitit 2025 janë prodhuar **13,436,525 m³**, që përbën **55.6% të planit vjetor**. Kjo tregon se jemi afër vijës së planifikuar (pritet të mbyllet viti me rreth 26.8 milionë m³ nëse vazhdon me këtë ritëm), që **tejkalon planin vjetor** me rreth 11%.

Rikthimi drejt kërkesës reale të konsumatorëve:

- Rritja e konsumit sezonal, ndryshimet klimatike dhe ndërlidhja e rrjetit me zona të reja furnizimi kanë ndikuar që nevoja për prodhim të ujit të jetë më e lartë sesa ishte parashikuar.

1. Tendenca e planifikimeve për 2026–2027:

- Vitet në vijim parashikojnë ulje graduale të sasisë së prodhimit. Nëse kërkesat reale vazhdojnë të jenë në nivelet e vitit 2024–2025, këto plane duhet të rishikohen për të ruajtur balancën ndërmjet ofertës dhe kërkesës.

Përfundim i përgjithshëm: performanca aktuale e prodhimit të ujit në vitin 2025, megjithëse tejkalon planifikimin, **është më e ulët se ajo e vitit 2024** dhe reflekton një **përshtatje graduale drejt eficiencës operative**, pa rrezikuar furnizimin stabil të konsumatorëve. Tejkalimi i planit vjetor nuk është rezultat i mbiprodhimit të paarsyeshëm, por një **përgjigje e nevojshme ndaj kërkesës reale**, e cila nuk është parashikuar saktë në projeksionet origjinale.

Gjatë gjashtëmujorit të parë të vitit janë realizuar disa furnizime bazë, si për klor dhe klorur ferik, ndërkohë që furnizimet tjera të nevojshme për mirëmbajtjen e impianteve të trajtimit të ujit janë përballur me sfida në procesin e prokurimit, për shkak të mungesës së interesimit nga operatorët ekonomikë. Si pasojë, ka pasur zvarritje në zbatimin e disa aktiviteteve të planifikuara.

Në këtë kontekst, dhe për të ruajtur trendin pozitiv të performancës prodhuese, planifikimi për gjashtëmujorin e dytë fokusohet në veprime konkrete që synojnë përmirësimin e operimit dhe sigurimin e kushteve të qëndrueshme për furnizim me ujë:

Riprocedim të prokurimeve të dështura me kushte dhe dokumentacion të përmirësuar tenderimi;

Furnizim dhe instalim i sensorëve për monitorim të parametrave të cilësisë së ujit;

Mirëmbajtje dhe përmirësim i sistemit të dozimit të klorit;

Rritje e furnizimeve teknike dhe pjesëve rezervë për të siguruar një operim të sigurt dhe efikas.

Këto masa janë të domosdoshme për të ruajtur stabilitetin e furnizimit, për të përmbushur objektivat vjetore dhe për të adresuar sfidat e paraqitura gjatë gjashtëmujorit të parë, duke e orientuar kompaninë drejt një menaxhimi më efikas dhe më të qëndrueshëm të burimeve dhe infrastrukturës së ujit.

Grumbullimi dhe trajtimi i Ujërave të Ndotura

Ujërat e ndotura të qytetit të Mitrovicës, Vushtrisë, Zveçanit dhe Zubin Potokut ende nuk trajtohen dhe vazhdojnë të derdhen në disa pika të lumit Ibër, Sitnica, Tërrstena, Lushte dhe lumi Trepça që rrjedh nga Tuneli i Parë deri në hyrje të qytetit të Mitrovicës. Kjo situatë do të vazhdojë deri në ndërtimin e Impiantit për Trajtimin e Ujërave të ndotura, i cili pritet të përfundon së bashku me kolektorët kryesor deri në fund të vitit 2027.

Grumbullimi dhe trajtimi i ujërave të ndotura momentalisht bëhet vetëm për komunën e Skenderajt, kryesisht të pjesëve urbane të cilat janë të kyçura në impiantin e Llaushës dhe një pjese tjetër e trajtimit biologjik sipërfaqësor në fshatin Tërnavc i cili trajtim njihet si trajtim i hapur me kallmishta do të vazhdojë edhe viteve në vijim 2025-2027.

Mirëmbajtja e automjeteve (autoparku)

Makineria aktuale e KRU “Mitrovica” Sh.A. vlerësohet si makineri e mangët në numër në njërin anë dhe e vjetruar në anën tjetër. Duke pas parasysh se në dy vitet e fundit ka një rritje të numrit të konsumatorëve, zgjerim të rrjetit të ujit të pijes dhe kanalizimit, si dhe synimet që i kemi për tri vitet e ardhshme, si rezultat i kësaj lind nevoja për investim në mjete transportuese për mirëmbajtjen e rrjetit të ujit, kanalizimit, mirëmbajtjen e ITU-ve, stacioneve të pompimit dhe leximin e faturave.

Mirëmbajtja e elektro makinerisë

Mirëmbajtja elektro makinerike është sektor, i cili mbikëqyrë dhe mirëmban pajisjet e elektro – makinerisë në të gjitha ITU-të dhe stacionet e pompave në nivel regjioni, në mënyrë që të sigurohet furnizimi 24 orë për konsumatorët tanë. Duke pasur parasysh se disa stacione të pompave janë të vjetruara kemi paraparë që brenda periudhës 2025-2027 të investohet në efikasitet dhe digjitalizim të stacioneve të pompimit, duke rritur kështu efikasitetin në punë.

Spektori GIS

KRU “Mitrovica” Sh.A. ka sistem funksional të GIS (Geographic Information System) dhe aplikon platformën ArcGIS Desktop Basic verzioni 10.6. Është i instaluar nga viti 2018 me licencë të ArcMap, licenca është single use, projekt i cili është financuar nga Lux Dev. Që nga viti 2018 me sigurimin e licencës së Arc GIS, kemi filluar që të bëjmë digjitalizimin e rrjetit të ujit (primar dhe sekondar), me të dhëna teknike nga projektet e përfunduara dhe të pranuar

teknikisht për tërë regjionin dhe të cilat janë dorëzuar në zyrën e sektorit të GIS-it, në kopje të fortë ose dixhitale si dhe në konsultim me Menaxherët e rrjetës së ujit të tri Njësive Operative, por që nuk janë me matje gjeodezike të verifikuara në teren (Google Earth Pro).

Gjatësia e rrjetit të ujit (primar dhe sekondar), të digjitalizuar në sistemin GIS gjerë me tani L= 1,421.72 km, nga gjatësia e rrjetit të ujësjellësit (primar dhe sekondar), L=1,665.485 km, e raportuar në ARRU nga Departamenti Teknik për vitin 2023, ndërsa kemi arritur të bëjmë digjitalizimin e aseteve: stacione të pompimit 36, rezervuar 59, valvule operuese 802 të hapura, 15 të mbyllura, valvula ajrimi 48, valvule të reduktimit të shtypjes 14, ujëmatës zonal 125, hidrant 60, defekte në rrjetin e ujit 739, pompa 80, ujëmatës në prodhim 5. Nga 51,834 konsumatorë të deklaruar nga Departamenti për konsumatorë për vitin 2024, janë të regjistruar në sistemin GIS në total 49,907 konsumatorë, dhe jemi duke vazhduar regjistrimin e të gjithë konsumatorëve në sistem.

Intervenimet apo defektet në rrjetin e ujit kemi filluar ti regjistrojmë në sistemin GIS nga viti 2023, me të dhënat e marra nga terreni nga ekipi i Mirëmbajtjes dhe deri më tani kemi 739 defekte të regjistruara në sistemin GIS.

Gjithashtu këtë vit kemi filluar regjistrimin e të dhënave për rrjetin e ujërave të zeza (kanalizimit), dhe kemi arritur të bëjmë digjitalizimin e 259.667 km nga 282.201 km të deklaruar nga Departamenti Teknik në ARRU për vitin 2023, dhe 1636 puseta të kanalizimit janë regjistruar në sistem.

Intervenimet apo defektet në rrjetin e ujërave të zeza kemi filluar ti regjistrojmë në sistemin GIS nga viti 2023, me të dhënat e marra nga terreni nga ekipi i Mirëmbajtjes dhe kemi 691 defekte të regjistruara deri më tani.

Objektivat specifike për vitin 2025

Të vazhdojmë me digjitalizimin e tërë rrjetit të ujësjellësit (primar dhe sekondar), për tërë regjionin që furnizojmë me ujë të pijshëm.

Të vazhdojmë të bëjmë digjitalizimin e të gjitha aseteve infrastrukturore dhe jo infrastrukturore me të dhënat teknike.

Ndërhyrjet në rrjet të ujësjellësit dhe rrjetin e ujërave të zeza (kanalizimit), të vazhdojmë ti regjistrujmë në sistemin GIS.

Të bëjmë regjistrimin e të gjithë konsumatorëve në sistemin GIS dhe ndërlidhjen online me sistemin e Faturimit (Billing).

Të bëhet ndarja e të gjitha DMA - zonave në bashkëpunim me Departamentin Teknik.

Sfidat

Sigurimi i sistemit GIS të licencuar në Server.

Mungesa e projekteve të përfunduara dhe të pranuar teknikisht.

Mungesa e një ekipi në teren për mbledhjen e të dhënave nga terreni.

Sigurimi i të dhënave të sakta për çdo konsumator në teren.

Planifikim dhe Zhvillimi

Divizioni i Planifikimit dhe Zhvillimit ka rol të rëndësishëm në menaxhimin e infrastrukturës: hartimin e planeve për ndërtimin e sistemeve të reja të ujësjellësit dhe kanalizimit, koordinimin dhe mbikëqyrjen e projekteve ndërtimore, përgaditja e raporteve përkatëse të shërbimit Teknik. Në bazë të Planit të Menaxhimit të Aseteve rrjedh tabela e investimeve vetanake dhe projekteve të identifikuara për 3 vitet e ardhshme.

6.6 PLANI I INVESTIMEVE

Lista e projekteve të planifikuara

Tabela 17. Investimet kapitale 2025

Investimet Vetanake të rishikuara 2025	
Emërtimi	Vlera në EURO
Administrata	105,005
“Projekti për furnizim me ujë në lagjen "Mazhiqet"”	9,498.15
Sistemet e Sigurisë dhe mbrojtjes në punë	35,000
Pajisje për matje gjeodezike GPS	12,000
Mirëmbajtja e rrjetit energjetik	50,000

Laboratori në ITU-Shipol- Paisja e mëtejshme e laboratorit me pajisje dhe inventar shtesë	20,000
IT	90,000
Gjithësej	321,503.15

6.7 Draft Lista e Projekteve të KRUM 2025 -2027

Prioritizimi i projekteve kapitale në sektorin e ujësjellësit bazohet në disa kritere kryesore, përfshirë:

1. Shkalla e Kritikalitetit: ky kriter vlerëson rëndësinë e projektit në mbështetje të infrastrukturës ekzistuese dhe përmbushjen e kërkesave të konsumatorëve. Projekte me shkallë të lartë kritikalitetit, që adresojnë probleme urgjente si rrjedhjet e ujit, cilësinë e ujit, ose nevojat për zgjerimin e kapaciteteve, zakonisht kanë prioritet më të lartë.
2. Analiza e kostos dhe përfitimit : Kjo analizë vlerëson përfitimet ekonomike, sociale dhe mjedisore të projektit në krahasim me kostot e tij. Projekte që ofrojnë përfitime të mëdha për konsumatorët, si ulja e kostove operative ose përmirësimi i shërbimeve, do të kenë një prioritet më të lartë.
3. Impakti te Numri i Konsumatorëve: Ky kriter analizon sa shumë konsumatorë do të përfitojnë nga projekti. Projekte që prekin një numër të madh konsumatorësh ose që kontribuojnë në përmirësimin e shërbimeve për grupe të vulnerabël do të jenë më të preferuara. Rritja e aksesit në ujë dhe përmirësimi i cilësisë së shërbimit janë gjithashtu faktorë të rëndësishëm.
4. Qëndrueshmëria afatgjate dhe qëndrueshmëria Mjedisore: Vlerësimi i ndikimeve mjedisore dhe qëndrueshmërisë afatgjatë të projekteve, përfshirë përdorimin e burimeve ujore në mënyrë të qëndrueshme, është një kriter tjetër i rëndësishëm.
5. Zbatueshmëria Teknike dhe Financiare: Kjo përfshin vlerësimin e aftësisë për të implementuar projektin në praktikë, përfshirë burimet njerëzore dhe financiare të nevojshme për realizimin e tij.
6. Bashkëpunimi me komunat për investime kapitale është thelbësor për zhvillimin e infrastrukturës së ujit.

Këto kritere ndihmojnë në sigurinë që projektet kapitale do të ofrojnë përfitime maksimale dhe do të përmbushin nevojat e konsumatorëve në mënyrë efikase dhe të qëndrueshme.

Tabela 18. Lista e projekteve te rishikuara 2025-2027

PROJEKTI		FINANCUESI					
	Përshkrimi	Vetanake	MZHE	BERZH, EIB, EBIF	Te tjera	Shuma parashikuar	Periudha e implementim it
<u>1</u>	Mitrovicë- Impianti I trajtimit të ujërave të zeza Mitrovicë-Vushtrri			39,300,000€		39,300,000€	2024-2030
<u>2</u>	Mitrovice , Vushtrri, Skenderaj, Funizimi dhe instalimi i sistemeve të sigurisë në rezervuar të ujit, stacionet e pompave të Kompanisë Rajonale të Ujesjellësit Mitrovica		200,000€			200,000€	2025-2026
<u>3</u>	Mitrovicë "Ndërimi dhe montimi i pompave në stacionet e pompimit (Tunel i Pare, Stanterg, Frasher)				125,000€ KIËER	125,000€	2025
<u>4</u>	Rregullatorët e presionit, ujëmatësit zonal, valvula ajrimi		70,000			70,000	2025
<u>5</u>	Mitrovicë - Ngritja e parkut, impianteve Energjetike Fotovoltaike (IEFV)				2,200,000€ KFË(nuk është konfirmuar ende)	2,200,000€	2025-2027
<u>6</u>	Mitrovice Skenderaj,Ndertimi i objekteve përcjellëse për Objektin administrativ në Suhodoll dhe Skenderaj (Depo dhe Garazha)		270,000€			270,000€	2025-2026

PROJEKTI		FINANCUESI					
	Përshkrimi	Vetanake	MZHE	BERZH, EIB, ĖBIF	Te tjera	Shuma parashikuar	Periudha e implementim it
<u>7</u>	Ndertimi i objekteve përcjellëse për Objektin administrativ,(Depo Garazha, rrethoja dhe mirembajtja e objektit te Drejtorise se Nj.O. - Vushtrri).		130,000€			130,000€	2025-2026
<u>8</u>	Vushtrri-Rehabilitimi I ujësjellësit në rrugët: “Arsim Muzaqi”, “Kruja”, “Naip Rashica”, “Fatmir Rashica”, “Hamdi Gashi”,” Aziz Halili”-Prapa Hotel Kalaja				180,000€ (Donator ose vetanake). Perveq Rruga “Hamdi Gashi” është rehabilituar nga KK-Vushtrri	180,000€	2025-2027
<u>9</u>	Pajisje per matje Gjeodozike “GPS”- Për të tri njesitë: Mitrovice, Skenderaj, Vushtrri.	12,000 €				12,000€	2025
<u>10</u>	Mitrovicë-Ndërrimi i gypit të ujësjellësit Rekë-Tunel i parë.	695,000€				695,000€	2025-2027

PROJEKTI		FINANCUESI					
	Përshkrimi	Vetanake	MZHE	BERZH, EIB, ĒBIF	Te tjera	Shuma parashikuar e	Periudha e implementimit
<u>11</u>	Vushtrri-Rehabilitimi I ujësjellësit për fshatin Dalak.				47,000 € Donator ose vetanake), e padeftinuar	47,000€	2025-2026
<u>12</u>	“Projekti per furnizim me uje ne lagjen "Mazhiqet"”	9,498.15€			14,247.22€ Bashkëftinancim KK-Vushtrri dhe KRUM	23,745.37€	Realizuar-2025
<u>12</u>	Vushtrri-Rehabilitimi I ujësjellësit për fshatin Akrahticë.				386,000€ Këtë do ta realizojë KK-Vushtrri	386,000€	2025-2026
<u>13</u>	Mitrovicë-Ndërrimi i gypit të kanalizimit në rrugët: Hoxhë Hasan Tahsini& rruga e Stadiomit dheAdriatiku.			195,000€ Këtë do ta realizojë Financuesi i ITUN		195,000€	2025-2027
<u>14</u>	Mitrovicë -Mjete Pune - Blerja e tre Eskavatorëve, per nevoja te		100,000€ Nje eskavator			100,000€	2025-2027

PROJEKTI		FINANCUESI					
	Përshkrimi	Vetanake	MZHE	BERZH, EIB, ĒBIF	Te tjera	Shuma parashikuar	Periudha e implementim it
	Operatives		deri tani				
<u>15</u>	Mitrovicē–Ilirida, Ndërrimi i rrjetit të Ujësjiellësit Rr. “Shaban Polluzha”,”Mesine Kokolari”, “Bashkimi Kombetar”, “Sebedin Prekazi”, “Halim Kajtazi”, “Jakup Ceraja”.	50,000€ Ēshtë në realizim				50,000€	2025
<u>16</u>	Skenderaj-Rehabilitimi I rrjetit të ujësjiellësit për rrugët 28 Nëntori (përfshinë rrugën Ali Gashi), Ahmet Delia, Fehmi&XhevëLladrovci.				107,000€ E padefinuar	107,000€	2026-2027
<u>17</u>	Mitrovicē–Ndertimi i rezervareve stacionet e pompimit dhe shtrirja e ujësjiellësit për disa fshatra të Shalës.				775,000€ KK- ne bashkpunim me KRU, E pakonfirmuar	775,000€	2026-2028

PROJEKTI		FINANCUESI					
	Përshkrimi	Vetanake	MZHE	BERZH, EIB, ĖBIF	Te tjera	Shuma parashikuar e	Periudha e implementim it
<u>20</u>	Vushtrri-Rehabilitimi i rrjetit të ujësjellësit për lokacionin ish-stacionin 'Mutfaja' tutje në rrugën 'Dëshmorët e kombit' deri në rezervuarin pasiv në fshatin Studime Nga puseta kryesore në rr.Ana Lin deri në rr.Shotë Galica.				KK-Vushtrri, veq se ka filluar me projektin e madh që i përfshin këto lokacione		2025-2027
<u>21</u>	Skenderaj-Rehabilitimi I rrjetit të ujësjellësit në rrugët Hoxha dhe Kaqkini & Arsim Sadiku-Klinë e mesme.	30,000€				30,000€	2026
<u>22</u>	Investimet ne IT per te tri njesite operative;Zhvillimi I Sistemit të pagesave offline ne pikat e arketimit;Furnizim me PC desktop dhe Laptop;Zhvillimi I moduleve në ERP dhe Billing etj.	90,000€				90,000 €	2025
<u>23</u>	Dy pompa shtytëse dhe rehabilitimi i stacionit në Suhodoll për Zveçan				250,000 €	250,000 €	2025

PROJEKTI		FINANCUESI					
	Përshkrimi	Vetanake	MZHE	BERZH, EIB, ĖBIF	Te tjera	Shuma parashikuar	Periudha e implementim it
<u>24</u>	Zëvendësimi i gypit furnizues DN 200 (2,500 m) Suhodoll-Zvecan				150,000 €	150,000 €	2025
<u>25</u>	Instalimi i 10,000 ujëmatësve në shtëpi dhe biznese				800,000 €	800,000 €	2025-2026
<u>26</u>	Blerja e 2 eskavatorëve				200,000 €	200,000 €	2025-2026
<u>27</u>	Blerja e një autobote për ujë				100,000 €	100,000 €	2025-2026
<u>28</u>	Blerja e 3 kamionetave operative				150,000 €	150,000 €	2025-2026
<u>29</u>	Blerja e 3 veturave(pickup) operative				100,000 €	100,000 €	2025-2026
<u>30</u>	Blerja e një kamioni për pastrim të kanalizimeve				150,000 €	150,000 €	2025-2026
<u>31</u>	Përfundim I rehabilitimit				500,000 €	500,000 €	2025-2026

PROJEKTI		FINANCUESI					
	Përshkrimi	Vetanake	MZHE	BERZH, EIB, ĖBIF	Te tjera	Shuma parashikuar e	Periudha e implementim it
	të fabrikës në Leposaviq						
<u>32</u>	Furnizimi me ujë për ITU- Leposaviq nga Soçanica (~6 km)				500,000 €	500,000 €	2025-2026
<u>33</u>	Lidhjet me gypin kryesor për Zubin Potok				500,000 €	500,000 €	2025-2026
<u>34</u>	Turbinë – Hidrocentral në fabrikën në Zubin Potok				200,000 €	200,000 €	2025-2026
<u>35</u>	Aktiviteti: Mirëmbajtja dhe Përmirësimi i Infrastrukturës në Objeket Administrative (Mitrovicë, Skenderaj dhe Vushtri) Ky aktivitet parasheh realizmin e punimeve të mirëmbajtjes dhe përmirësimit në objektet administrative në Mitrovicë, Skenderaj dhe Vushtri, me fokus në lyerjen e ambienteve të brendshme dhe të jashtme, renovimin e banjove (përfshirë ndërrimin e elementeve				36,245 €	36,245 €	2025-2026

PROJEKTI		FINANCUESI					
	Përshkrimi	Vetanake	MZHE	BERZH, EIB, ËBIF	Te tjera	Shuma parashikuar	Periudha e implementim it
	sanitare dhe pllakave), rregullimin e pllakave në shkallë si dhe ndërhyrje të tjera të domosdoshme për përmirësimin estetik dhe funksional të hapësirave.						
<u>36</u>	Rregullimi i Kulmit ne Drejtorinë e KRUM Planifikohet rregullimi i plotë i mbulimit me qëllim parandalimin e dëmtimeve të mëtejshme në infrastrukturë dhe pajisje teknike, si dhe ruajtjen e kushteve optimale të punës brenda objektit.				68,760 €	68,760 €	

PROJEKTI		FINANCUESI					
	Përshkrimi	Vetanake	MZHE	BERZH, EIB, ĖBIF	Te tjera	Shuma parashikuar	Periudha e implementim it
<u>37</u>	Investimi ne ITU-Shipol dhe ITU Shipol: Përmirësimi i SCADA, Dozimit dhe Infrastrukturës Teknike në ITU-Shipol Ky projekt synon automatizimin e plotë të operimit në ITU-Shipol, përmes aktivizimit të leximit automatik të të dhënave përmes SCADA, eliminimit të ndërhyrjeve manuale. Po ashtu, përfshin rregullimin e dhomave dozuese instalimin e sistemit për dozim automatik të kimikateve dhe funksionalizimin e gjeneratorit te ozonit, me qëllim rritjen e efikasitetit, sigurisë dhe cilësisë në prodhimin dhe shpërndarjen e ujit të pijshëm. (1.Objekti i klorit: duhet të investohet në funksionalizimin e sistemit automatik të dozimit dhe		125,000 € Ridestitim I mjeteve nga pompat dhe digjitalizimi I stacioneve te pompimit			125,000 €	

PROJEKTI		FINANCUESI					
	Përshkrimi	Vetanake	MZHE	BERZH, EIB, ËBIF	Te tjera	Shuma parashikuar	Periudha e implementim it
	investime në blerje të bombolave 1,000 kg, injektoreve, senzoreve detektues të gazit, gypave transmetues të klorit nga kontinieri deri të injektoret, senzoret për matjen e klorit, filtrat, valvula etj. 2) Objekti të Filtrat: auma, pajisje të IT-së, shtëitch-a. 3). Objekti të ozoni dhe trajtimi i llumit: servisimi e gjeneratorit të ozonit dhe kompresorit të ajrit si dhe investime në kthimin në punë të njësisë e trajtimit të llumit. 4). Objekti i kemikaleve: sigurimi i pompave të reja dozuese. 5). Blerja e të gjithë senzoreve (sondave) për matjen e parametrave përmes SCADES. 6). Pajisje të IT-së, makinerisë dhe elektros.						

PROJEKTI		FINANCUESI					
	Përshkrimi	Vetanake	MZHE	BERZH, EIB, EBIF	Te tjera	Shuma parashikuar	Periudha e implementim it
	7). Stacioni i pompave në Lushtë: sigurimi xhundave dhe kushinetave, qarqet e pompave, amortizues të gypave, pjese elektike, IT-së dhe makinerisë.)						
38	Laboratori në ITU-Shipol- Paisja e mëtejshme e laboratorit me pajisje dhe inventar shtesë, në mënyrë që të rritet kapaciteti dhe efikasiteti i punës laboratorike, si dhe të përmirësohet siguria dhe saktësia e analizave. Investimi do të përfshijë blerjen e pajisjeve laboratorike shtesë, materialeve harxhuese dhe mobilimit ndihmës, duke kontribuar në përmbushjen më të plotë të kërkesave të standardeve				60,000	60,000	

PROJEKTI		FINANCUESI					
	Përshkrimi	Vetanake	MZHE	BERZH, EIB, ËBIF	Te tjera	Shuma parashikuar	Periudha e implementim it
	të cilësisë dhe raportimit. Ky projekt do të ndihmojë në përforcimin e monitorimit të brendshëm dhe në rritjen e besueshmërisë së të dhënave analitike						
39	Furnizim dhe montim I klorinatorit me sistem te automatikes	4000				4000	2025
	Totali:	890,498.15€	895,000 €	39,495,000 €	7,399,252.22 €	48,679,750.37 €	2025-2027

7. STRATEGJIA E MARKETINGUT & MARRËDHËNIET ME PUBLIKUN

7.1 Qëllimi dhe Objektivat Strategjike

Strategjia jonë përbën një pjesë kyçe të zbatimit të aktiviteteve për sigurimin e infrastrukturës së qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse të shërbimeve, të orientuar drejt konsumatorit. Përfshirja dhe angazhimi i konsumatorëve dhe palëve të interesit do të përqendrohet në mundësimin e pjesëmarrjes së tyre përmes informimit, konsultimit, bashkëpunimit dhe fuqizimit, duke shërbyer si nxitje për zbatimin e strategjive tona afatgjata.

Qëllimi përfundimtar i kësaj strategjie është avancimi i kanaleve të komunikimit me konsumatorët, duke ofruar aktivitete ndërgjegjësimi dhe informimi që do të kontribuojnë në përmirësimin e imazhit të kompanisë.

7.2 Komunikimi

Komunikimi, si një mjet i domosdoshëm për punën e përditshme, është thelbësor për arritjen e objektivave të kompanisë sonë. Përfshirja e palëve të interesit dhe publikut të gjerë ndihmon në sigurimin e qëndrueshmërisë dhe përmirësimin e shërbimeve përmes komunikimit efektiv.

Ky proces synon të informojë konsumatorët lidhur me:

- Qasjen ndaj ujit të pijshëm: shfrytëzimi racional, kursimi, pagesa e rregullt, mirëmbajtja, etj.
- Mbrojtjen e burimeve ujore: ruajtja e pastërtisë, veçanërisht në afërsi të burimeve dhe mosndotja e ambientit.
- Sëmundjet hidrike: vetëdijesimi mbi rrezikun shëndetësor si pasojë e ndotjes së ujit të pijshëm.
- Planet afatgjata të zhvillimit: informimi i qytetarëve mbi planet e ardhshme të zhvillimit.
- Të drejtat dhe obligimet e konsumatorëve.
- Legjislacionin: ligjet, rregulloret, udhëzimet administrative, etj.

7.3 Marketingu

Marketingu është një komponent i rëndësishëm për promovimin e punës, vlerave dhe shërbimeve të KRU “Mitrovica” Sh.A. Duke pasur parasysh rëndësinë e promovimit të aktiviteteve të kompanisë dhe ndikimin e tyre në imazh dhe performancë, kemi planifikuar që nga viti 2025 marketingut t’i kushtohet një kujdes i veçantë. Synojmë të organizojmë sa më shumë ngjarje për të mbajtur lidhje të ngushtë me konsumatorët.

Një ndër aktivitetet kryesore do të jetë shënimi i “Ditës Botërore të Ujit” më 22 mars, i cili do të përfshijë një numër të madh pjesëmarrësish, me theks në institucionet arsimore të rajonit të Mitrovicës.

Në kuadër të marketingut, është paraparë edhe përgatitja e një dokumentari të shkurtër televiziv, për të cilin do të angazhojmë një medium televiziv. Ky dokumentar do të shfaqë në mënyrë vizuale të gjitha aspektet e ujësjellësit, nga kaptimi i ujit në Lushtë deri tek uji që rrjedh nga rubineti, duke përfshirë arritjet, mundësitë, sfidat dhe planet zhvillimore për të ardhmen

Tabela 19. Aktivitetet dhe buxheti për Informim Marrëdhënie me Publikun dhe Marketing

PËRSHKRIMI	2025	2026	2027
AKTIVITET AVOKUESE	1,000	5,250	5,513
AKTIVITETET PROPAGANDUESE TË EDUKIMIT DHE VETËDIJESIMIT	1,000	5,250	5,513
PLANIFIKIMI DHE PËRGATITJA E FUSHATAVE	3,000	15,750	16,538
MEDIA – PËRFSHIRJA E MEDIAVE NË AKTIVITETE	2,000	10,500	11,025
TË TJERA	3,000	15,750	16,538
TOTAL	10,000	52,500	55,125

8. SHTOJCAT:

Tabela 20. Caqet kryesore të performancës të rishikuara

Të Dhënat dhe Caqet Kryesore të Përformancës të rishikuara	Planifikimi i Performancës në 2025-27		
	2025	2026	2027
D 001 Uji i prodhuar (m3)	27,780,880	25,500,000	24,500,000
D 002 Konsumatorët e regjistruar (të faturuar) (nr.)	70,460	74,883	76,374
<i>D 002.1 Konsumatorët shtëpiak (nr.)</i>	63,392	69,000	70,380
<i>D 002.1.1 Konsumatorët shtëpiak me ujematje (nr.)</i>			
<i>D 002.2 Konsumatorët kom. (bisnese) (nr.)</i>	6,442	5,250	5,355
<i>D 002.2.1 Konsumatorët kom. (bisnese) me ujematje (nr.)</i>			
<i>D 002.3 Konsumatorët kom. (institucione) (nr.)</i>	626	633	639
<i>D 002.3.1 Konsumatorët kom. (institucione) me ujematje (nr.)</i>			
D 004 Uji me shumicë i faturuar (m3)	4,191,420	0	0
D 005 Uji i faturuar (m3)	9,807,749	14,371,904	14,515,623
<i>D 005.1 Uji i faturuar (amviseri) (m3)</i>	8,032,880	12,513,538	12,638,673
<i>D 005.2 Uji i faturuar (biznese) (m3)</i>	1,072,269	1,141,715	1,153,132
<i>D 005.2.1 Uji i faturuar për konsum, me ujëmatës (biznese) (m3)</i>	0	0	0
<i>D 005.3 Uji i faturuar (institucione) (m3)</i>	702,600	716,652	723,819
<i>D 005.3.1 Uji i faturuar për kons, me ujëmatës (institucione) (m3)</i>	0	0	0
D 006 Faturimi (€)	6,678,432	6,812,001	6,880,121
<i>D 006.1 Faturimi për amviseri (€)</i>	4,571,070	4,662,491	4,709,116
<i>D 006.2 Faturimi për biznese (€)</i>	958,556	977,727	987,504
<i>D 006.3 Faturimi për institucione (€)</i>	436,265	444,990	449,440
<i>D 006.3 Faturimi nga uji me shumicë (€)</i>	712,541	0	0
D 007 Arkëtimi (€)	5,309,448	5,468,731	5,632,793
<i>D 007.1 Arkëtimi për amviseri (€)</i>	4,142,594	4,266,872	4,394,878
<i>D 007.2 Arkëtimi për biznese (€)</i>	730,588	752,506	775,081
<i>D 007.3 Arkëtimi për institucione (€)</i>	436,265	449,353	462,834

<i>D 007.3 Arkëtimi nga uji me shumicë (€)</i>	0	0	0
D 008 Të hyrat nga kyqjet dhe të tjera	30,000	30,000	30,000
D 009 Shpenzimet operative pa amortizim	6,049,492	5,882,098	5,929,962
D 010 Shpenzimet jo operative (investimet vetanake)	321,503		
D 011 Numri i punëtorëve	390	390	390
I 001 Uji i pafaturuar (%)	50%	44%	41%